



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 12.07.2016, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të komisionit datë 11.07.2016
2. Vazhdimi i shqyrtimit nen per nen i projektligjit “Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise” (nga neni 23)
3. Prezantimi i projektligjit “Per organizimin dhe funksionimin e institucioneve per te luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”,

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Petrit Vasili dhe Vexhi Muçmata.

**Mungon:**

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Keltis Kruja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

**Të ftuar:**

Rainer Deville – ekspert i Nivelit te Larte, shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

John Smibert – ekspert i Nivelit te Larte, përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

Agnes Bernhard – eksperte e Nivelit te Larte, zëvendësshefe e misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Korajlka Bumçi - eksperte e Nivelit te Larte, përfaqësuese e misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Aurela Anastasi - eksperte e Nivelit te Larte

Arben Rakipi - ekspert i Nivelit te Larte

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Jemi në procesin e shqyrtimit nën për nen.

Kemi përfunduar nenin 22, do të vazhdojmë me nenin 23, me ndihmën e relatorit, zotit Manja, dhe të ekspertëve, gjithashtu të gjithë ne të tjerët, për ta shqyrtuar hap pas hapi.

Vazhdojmë me nenin 23.

Po, zoti Manja.

**Ulsi Manja** – Në lidhje me nenin 23 nuk ka ndonjë gjë të veçantë, thjesht në paragrafin e parë, germa “a” ka riformulim sipas variantit që është në tabelë, por riformulim ka edhe me germën “c” për ta përshtatur. Këtu thuhet: “të plotësojë kërkesat e ligjit “Për dekriminalizimin””, në fakt, në germën “c” thuhet: “të plotësojë kërkesat e ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen...”, pra është përshtatur...

**Fatmir Xhafaj** – Emri i ligjit, po.

**Ulsi Manja** – ...me terminologjinë ligjore.

Nuk kam gjë tjetër për këtë nen.

**Vasilika Hysi** – Kryetar...

**Fatmir Xhafaj** – Po?

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Për paragrafin e parë kam një riformulim të fjalisë së dytë. Mendoj se është e tepërt të themi që “për efekt të integritetit moral dhe profesional, sipas nenit 145/a të Kushtetutës”. Kjo të hiqet, pasi në fjalinë e parë kemi thënë që kandidati për prokuror të Përgjithshëm duhet të përmbushë kushtet e parashikuara nga neni 148/a.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vasilika Hysi** – Në këto kushte, sugjeroj që paragrafi i parë të lexohet: “Kandidati për prokuror të Përgjithshëm duhet të përmbushë kushtet e parashikuara nga neni 148/a i Kushtetutës. Kandidati për prokuror të Përgjithshëm duhet të plotësojë kushtet ligjore si vijon...” dhe të fillojmë atë riformulim që ka bërë kolegu në vijimësi.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

**Vasilika Hysi** – Kam edhe pyetje për ekspertët.

Ju keni thënë: “Personi nuk duhet të ketë qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete dhe të huaja”, ndërkohë në ligjin “Për qeverisjen e pushtetit gjyqësor të sistemit të drejtësisë” ne kemi vënë dy kushte: përveç kushtit: të mos jetë, edhe të mos ketë qenë. Pra, në fakt, ka dy kushte, ndërsa këtu shoh vetëm njërin.

**Pyetja e parë:** përse është hequr?

**Pyetja e dytë:** ju keni parashikuar, me shumë të drejtë, që nuk duhet të ketë qenë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit. Ne kemi miratuar një ligj. Nga ana tjetër, në ligjin “Për qeverisjen e pushtetit gjyqësor” ju keni vënë afate qoftë për prokurorin e Përgjithshëm, qoftë edhe për anëtarët e tjerë, për të cilët verifikimi duhet bërë brenda shtatë ditëve. Në momentin kur ne nuk i kemi hapur ende dosjet si mund të arrihet verifikimi nëse personi ka qenë punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit ose i favorizuar prej tij, meqenëse ne...?

**Fatmir Xhafaj** – Po si ta bëjnë? Ke ndonjë zgjidhje si ta bëjnë...?

**Vasilika Hysi** – E dyta...

**Fatmir Xhafaj** – ...se ata janë të huaj, ti je shqiptare. Si do ta bëjnë një gjë...?

**Vasilika Hysi** – Jo, e them për shqiptarët.

**Fatmir Xhafaj** – Ja, ti vetë si do ta bëje?

**Vasilika Hysi** – Unë nuk e di. Unë e kam parë si vështirësi.

**Fatmir Xhafaj** – Si e kemi bërë deri sot?

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, unë e kam parë një vështirësi edhe te ligji “Për qeverisjen...”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, por si e kemi bërë deri sot, se kjo ka qenë edhe sot për prokurorin e Përgjithshëm? Siç e kemi bërë deri sot, atë të bëjmë.

**Vasilika Hysi** – Po nuk është...

*(Deputeti Majko ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, jo, shumë mirë që të mos jetë! Ato duhet të jenë, por si do të bëjnë verifikimin?

**Fatmir Xhafaj** – Kur të hapen dosjet, do të bëjmë prokuror të Përgjithshëm në Shqipëri! Ja nuk hapen asnjëherë dosjet, si do të bëjmë?

**Vasilika Hysi** – E pra, këtë them, për brenda shtatë ditëve që kemi vënë më pas afatin. Unë po i lidh të dyja ligjet.

**Fatmir Xhafaj** – Po pra, dakord.

Ke të drejtë te pjesa që duhet të kenë të njëjtin standard, por te pjesa sesi do të bëhet kur nuk kemi hapur dosjet, nuk ke të drejtë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Do t'u drejtohen autoriteteve që kanë sot akses mbi to dhe do të kthejnë përgjigje. Në qoftë se ato kthejnë përgjigje: “Është në rregull”, atëherë në rregull. Më kupton? Se nuk do të presim ne sa të bëhet autoriteti.

Kur të bëhet..., se nuk bëhet dot, zonja Hysi.

Nëse e bën dot ti, na e thuaj, po të kesh një formulë.

**Vasilika Hysi** – Jo, jo, këto janë kushte shumë të drejta që janë vendosur në ligj, por të mos i lëmë të pamundura, të realizohen në praktikë.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull. Biem dakord me vërejtjet dhe sugjerimet që u bënë, si dhe me ndryshimin e propozuar për pikën 1 të këtij neni dhe propozimet e tjera të parashikuara? Dakord neni 23, me ndryshimet.

*(Deputeti Majko ndërhyr pa mikrofon.)*

Neni 24 “Kriteret për vlerësimin e kandidatëve”.

**Ulsi Manja** – Shprehemi dakord për nenin 24, por propozojmë...

**Fatmir Xhafaj** – Hiqet fjala “menaxheriale”.

**Ulsi Manja** – ...të hiqet fjala “menaxheriale”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Ka sugjerime të tjera? Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me paragrafin e dytë, ku thuhet: “Në rast se kandidatët kanë të njëjtën meritë”, besoj se kanë të njëjtin vlerësim, pra duhet të përdorim të njëjtën gjuhë si në ligjet e tjera kur flasim për vlerësimin e kandidatëve. Këtu do t'i referohesha terminologjisë së përdorur në ligjin “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Vasilika Hysi** – Gjithashtu, në pikën 3, ku thuhet: “Këshilli zbaton parashikimet e bëra në këtë kre”, jo dispozitat e këtij kreu, sepse në këtë kre ka edhe dispozita të tjera që nuk lidhen me kriteret e vlerësimit, por parashikimet e bëra për vlerësimin në këtë kre.

Gjithashtu, për sa i përket aktit normativ, “Këshilli, në zbatim të dispozitave të këtij kreu...”, thotë “...përcakton me akt normativ”. Shprehja “Merr vendim, vendos” duhet të jetë më e sakta. Ky është i njëjti funksion, ndaj duhet përdorur e njëjta gjuhë si në rastin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili ka të bëjë me vlerësimin e gjyqtarëve.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Vasilika Hysi** – Gjithashtu, në germën “c” të pikës 3, ku thuhet: “Procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta”, të thuhet: “në procesin e vlerësimit”.

**Fatmir Xhafaj** – Po, aty është, për vlerësimin është.

**Vasilika Hysi** – Po, por...

**Fatmir Xhafaj** – Përderisa është për vlerësimin, e gjitha, në këtë proces.

**Vasilika Hysi** – ...të të gjithë vlerësimit.

Ne kemi tri lloje vlerësimesh: vlerësim të pasurisë, të etikës dhe të profesionalizmit.

Ky do të jetë rezultati, pikët e barabarta në totalin e vlerësimit.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk do të dalin ndonjëherë me pikë të barabarta, aq sa të...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Vasilika Hysi** – Po.

**Fatmir Xhafaj** – Gjithsesi, dakord, të jetë në vëmendje për stilistikë.

Po, zoti Vasili, ju lutem!

**Petrit Vasili** – Kam vetëm diçka për germën “b”, në fund fare te pika 2 “b”. Mendoj që kriteret për matjen e rezultateve të vlerësimit duhet t’i korrigjojmë për një arsye shumë të thjeshtë. Vlerësimi është vlerësim, nuk matet vlerësimi. Vlerësimi është sipas shkallëve që kemi përkatësisht. Por të themi: “Kritere për matjen e rezultateve të vlerësimit”, nuk maten rezultatet e vlerësimit. Ose bëjmë vlerësim dhe është ky, ky, ky, dhe ai vlerësim i bërë ka brenda edhe rezultatet... Si t’i masim? Do të masim rezultatet e vlerësimit?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ndoshta është shkruar në anglisht dhe është përkthyer keq.

**Fatmir Xhafaj** – Kam përshtypjen...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, nuk është shkruar në anglisht, sepse është shkruar direkt në shqip ky si projekt.

Them unë, por ndoshta duhet thënë: “Kritere...

**Petrit Vasili** – Rezultatet e vlerësimit dhe kritere të tjera.

**Fatmir Xhafaj** – Dhe kritere të tjera”. Po, më thjesht fare. Në rregull.

Biem dakord, atëherë, me këto ndryshime? Dakord me nenin 24, me ndryshimet e miratuara.

I mbajtët, Moza?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Faleminderit!

Neni 25 “Kriteret e vlerësimit profesional”.

**Ulsi Manja** – Shprehemi dakord, nuk kemi ndonjë gjë për këtë nen.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull. Faleminderit!

Neni 26 “Kriteret e vlerësimit të integritetit moral dhe profesional”.

**Ulsi Manja** – Te neni 26, paragrafi i dytë, ne propozojmë riformulimin e këtij paragrafi dhe themi: “Vlerësimi i integritetit bazohet në cilësitë morale që një prokuror duhet të zotërojë me sjelljen e tij në mënyrë koherente në shoqëri”.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

**Ulsi Manja** – Nuk kemi gjë tjetër.

**Petrit Vasili** – Më falni, Fatmir, një pyetje!

**Fatmir Xhafaj** – Nuk ka problem! Urdhëroni!

**Petrit Vasili** – Te neni 25, e kam fjalën për këtë: pse duhet ta bëjmë kufizimin për sa i takon kësaj që quhet “veprimtari shkencore”? Them: “Vlerësimi i publikimeve dhe pjesëmarrja në aktivitete shkencore përgjatë pesë vjetëve të fundit”. Veprimtaria shkencore nuk ka limit, është veprimtari e akumuluar dhe nuk mund t’ju them unë... Madje ai para pesë vjetëve mund të ketë pasur...

**Fatmir Xhafaj** – Se nuk parashkruhet ajo. Mund të ishte masa disiplinore që parashkruhet, sepse ka një afat.

**Petrit Vasili** – Por jo shkenca.

**Fatmir Xhafaj** – Shkenca jo.

**Petrit Vasili** – Prandaj po them që veprimtaria shkencore dhe...

**Fatmir Xhafaj** – Se ai ka një jetë të tërë, ndërkohë del njëri që del talent në tre vjet.

**Petrit Vasili** – Këtë po them. Mund të ketë pasur një shkak mjekësor dhe nuk ka qenë më aktiv, por mund të ketë qenë shumë aktiv ky që unë them që...

Kriteri i pesë vjetëve...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Atëherë, Moza, te neni 25, germa “d” e pikës 2 duhet të jetë, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Mimoza Arbri** – Germa “d” e pikës 1.

**Fatmir Xhafaj** – Hiqeni pikën 1 fare, se nuk keni fare pikë 2.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Hiqeni pikën 1. Ja që bëri mirë zoti Vasili që na ktheu mbrapsht, se kemi një pikë me disa germa dhe nuk kemi pikë 2 fare.

Pra, te germa “d” nuk duhet vendosur ky kufizimi. Dakord?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në rregull, faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 26.

**Ulsi Manja** – Pra, në paragrafin e dytë...

**Fatmir Xhafaj** – Po, ramë dakord.

**Ulsi Manja** – ...të hiqet lidhëza “edhe”.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me paragrafin e parë, sugjeroj që të riformulohet, ku të thuhet: “Integriteti moral dhe profesional i kandidatit përcaktohet nga reputacioni që ai gëzon në shoqëri si rezultat i mënyrës sesi është sjellë gjatë ushtrimit të funksionit të tij dhe jashtë tij”. Me fjalë të tjera të unifikojmë terminologjinë me ligjin “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”. Ne kemi brenda funksionit dhe jashtë tij.

**Fatmir Xhafaj** – Atje këtë term kemi përdorur.

**Vasilika Hysi** - Te paragrafi i dytë: “në mënyrë koherente”, të bëhet “në mënyrë të vazhdueshme”.

Te paragrafi i katërt sugjeroj të saktësojmë, të shtojmë në fund të fjalisë, ku të thuhet: “Sipas parashikimeve të nenit 24 të këtij ligji”.

**Fatmir Xhafaj** - Janë redaktoriale.

Po, zoti Vasili.

**Petit Vasili** – Unë sinqerisht i kam thënë dhe më parë këto rezerva lidhur me këtë nen. Hajdeni ta pranojmë meqenëse është ky nen!

Së pari, do të thosha se që në titull duhet të ishte: “Kriteret e vlerësimit të integritetit”. Ka edhe integritet moral profesional, këto shtesa nuk na çojnë gjëkund, pasi integriteti është goxha i gjerë.

Elementi i dytë, sa të jetë e mundur, nëse kemi mirëkuptim ta krehim nga gjëra të tilla si: ndershmëria, përpikëria, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti janë moralizma kaq të shumta që nuk i mban ligji. Po jua them me sinqeritet. Në ligj ka mjaft elemente pozitive për t’iu qasur të vërtetës së integritetit nëpërmjet kriterëve. Mund të themi: “përpikëria në ushtrimin e detyrave”, se ajo matet, jam dakord, por të matim tani se cila është besueshmëria apo integriteti? Nëse ka përpikëri në kryerjen e detyrave, nëse ka indekse të larta të performancës profesionale, të gjitha janë brenda. Nuk mund të jesh edhe me mendime të sakta, edhe i përpiktë, por mund të jesh i pandershëm. Është e nënkuptuar se je i ndershëm, i paanshëm, i besueshëm. Prandaj them që në këtë pikë ne nuk e pasurojmë këtë dispozitë, që kemi këtu, të gjithë këtë nen nuk e pasurojmë. Do të ketë komente të panevojshme që nuk na përkasin, sepse ligji është goxha i mirë. Mund ta qërojmë fare mirë dhe të themi: “integriteti profesional”. Nga ana morale, po shumë mirë, përpikëria në raport me këtë dhe mbaroi. Se si mund të jetë ky edhe i përpiktë, i ka bërë në rregull, mund të jetë dhe i paanshëm. Përpikëria dhe rezultatet e mira profesionale i kanë brenda të gjitha. Në



këtë pikë ta shikojmë edhe një herë tjetër për ta zhveshur nga këto gjëra të pamatshme dhe të papërcaktueshme.

**Fatmir Xhafaj** - Duhet të shikohet që të pastrohet pak. Ka të drejtë. Se janë disa që janë shumë voluntive ose përplasen me njëra tjetrën edhe nga pikëpamja e fjalorit gjuhësor.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Te statusi është më i thjeshtë, ajo e statusit mund të merret për analogji.

Dakord.

Neni 27 “Kriteret e vlerësimit të aftësive organizative, drejtuese dhe menaxheriale”.

Hiqeni fjalën “menaxheriale”.

**Ulsi Manja** - Te neni 27, propozojmë të hiqet që në titull fjala “menaxheriale” dhe të ketë riformulim të pikës 1.

“Aftësitë organizative dhe drejtuese të kandidatit vlerësohen sipas kriterëve” të hiqet edhe këtu fjala “menaxheriale”.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

Neni 28 “Kritere të tjera vlerësimi”.

Dakord me shënimin që keni bërë për ta riformuluar.

**Ulsi Manja** – Po, me riformulimin që kemi bërë.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 29 “Organi përgjegjës për përzgjedhjen”.

**Ulsi Manja** - Për hyrjen në fuqi të ligjit duhet t’i referohemi Kushtetutës.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

Neni 30 “Thirrja për aplikime” .

**Ulsi Manja** - Dakord. Të hiqet fjala “mjaftueshëm” dhe të zëvendësohet me fjalën “më të lartë”.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

Neni 31 “Paraqitja e kërkesave për kandidim”.

**Ulsi Manja**- Te neni 31 propozojmë të hiqet fjala “gjithashtu” dhe fjala “të mëposhtme”.

Në nenin 31, paragrafi i tretë të hiqet fjala “mund”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimet.

Neni 32 “ Verifikimi paraprak i kushteve ligjore”.

**Ulsi Manja** - Unë nuk kam gjë.

**Fatmir Xhafaj** – Keni ndonjë gjë ju që keni sjellë ligjin?

**Artan Hoxha** –Te neni 32 duhet vënë i njëjti rregullim që e kemi te neni 35. “Vendimi i gjykatës është i formës së prerë dhe i paankimueshëm”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Te paragrafi i gjashtë, i fundit. “Verifikimi paraprak i kushteve ligjore”.

**Fatmir Xhafaj** - Te pika 6 e nenit 32?

**Artan Hoxha** – “Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë” sikurse është rregullimi te neni 35.

**Fatmir Xhafaj** - Gjithmonë vendimi i Gjykatës së Apelit?

**Artan Hoxha** - Po.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord me nenin 32 me ndryshimin që u bë.

Neni 33.

**Vasilika Hysi** – Te neni 32 kam disa propozime lidhur me terminologjinë, sepse kemi një ligj “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit”. Në ligjin “Për qeverisjen”, në pjesën e dytë, në nenin 30 thuhet që një sërë dispozitash të këtij kreu zbatohen *mutatis mutandis* për këtë ligj. Shikoj që terminologjia që përdore nuk është e njëjtë.

**Fatmir Xhafaj** - Biem dakord që gjatë zbardhjes terminologjia gjatë gjithë këtij ligji të përputhet me dy ligjet e tjera që të mos kemi përplasje të terminologjisë, që të mos i përsërisim herë pas here.

**Vasilika Hysi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Jemi dakord në parim? Pastaj ju të dy relatorët, t’i shikoni bashkë me këshilltarët

Që të mos e përsërisim më kur ka shprehje të kësaj natyre, e konsiderojmë të mirëqenë për të gjitha nenet vijuese.

Neni 33 “Renditja e kandidatëve”.

**Ulsi Manja** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 34 “Seancat dëgjimore”.

**Ulsi Manja** – Në fakt, për nenin 34 kam vetëm një pyetje, më tepër për t’u qartësuar: pse është parashikuar seancë dëgjimore vetëm me gjashtë kandidatët e renditur të parët në listë dhe jo për të tjerët?

Për nenin 34/3 është më tepër çështje e teknikës legjislative dhe sugjerojmë që pas fjalës “faqe”, të hiqet fjala “e saj, ose” dhe të zëvendësohet me “e tij”.

**Artan Hoxha** - Lidhur me përcaktimin e gjashtë kandidatëve Kuvendit i shkojnë tre dhe gjithë procedura që është vendosur, komisioni, këshilli, e drejta për t’u verifikuar nga gjykata e të tjera, në fund do të përcaktojë gjashtë të renditurit më lart, do të përcaktojë të gjithë renditjen e 20, 30, 40 nuk e dimë sesa kandidatë do të jenë, por në fund të ditës tre do t’i shkojnë Kuvendit. E drejta për t’u verifikuar nga gjithsecili paraprakisht përpara renditjes,

ekziston. Të futësh në seancë dëgjimore 20, 30 kandidatë, ndërkohë që do të bësh vetëm një seancë formale, ajo që do të ndajë kandidatët janë ata që janë në grupin e parë dhe diskutimi që kemi bërë brenda nesh, eksperiencia e vendeve të tjera është që kandidatët të cilët renditen më lart, që është dyfishi i numrit të atyre që do të propozohen. Janë edhe ata që kanë hyrë në seancën dëgjimore, nuk kanë nevojë që të dëgjohen të gjithë, kur nuk mund të renditen. Seanca dëgjimore vetëm do të verifikojë disa gjëra, të cilat, do të shikohen sesi është komunikimi i kandidatit, çfarë aftësisht ka, disa elementë që janë të karakterit subjektiv, kurse elemente që janë të karakterit objektiv janë të verifikimi, që i ka bërë komisioni paraprakisht dhe KLD-ja.

**Fatmir Xhafaj** - Edhe relatori, pavarësisht rezervës që shprehu, po jep mirëkuptim.

**Ulsi Manja**- Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 35 “Ankimimi”.

Relatori thotë që paragrafi i parë do të ndahet në dy paragrafë.

Dakord! Po.

**Vasilika Hysi** – Në ligjet e tjera, si në ligjin për qeverisjen, ka afate të tjera të animimit. Ne kemi pasur një diskutim të gjatë me zonjën Agnes dhe me ekspertët e tjerë, qoftë te ligji “Për statusin e gjyqtarit e të prokurorit”, ashtu edhe te ligji “Për qeverisjen”, dhe tha se do të zbatohen afatet e përcaktuara në ligjin “Për qeverisjen”. Pra, duhet të ketë afate standarde të animimit.

**Fatmir Xhafaj** – Po pra, ramë dakord se do t’i përputhim.

**Vasilika Hysi** – Po kjo këtu është çështje afati tani, jo terminologjie. Pra, ka afate të ndryshme. Te ligji “Për qeverisjen” është një nen i përgjithshëm, që e përcakton qartë se cilat janë afatet e animimit.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord! Përputhini, që të mos kemi dy gjëra të ndryshme.

Dakord me ndryshimet e propozuara te neni 35.

Neni 36: “Emërimi i prokurorit të përgjithshëm”.

**Artan Hoxha** – A të bëj një ndërhyrje për nenin 35?

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Artan Hoxha** – Te germa “a” e pikës 3, të hiqet shprehja: “me përfundimin e afateve të ankimit”, sepse nuk është e nevojshme.

**Fatmir Xhafaj** – Po, dakord!

**Artan Hoxha** – Pra, në rast se brenda afatit ligjor nuk është bërë ankim.

**Fatmir Xhafaj** – Qartë! Në rregull!

**Ulsi Manja** – E kemi të formuluar ne.

**Fatmir Xhafaj** – Në tabelën që ndodhet këtu, është riformuluar, është e qartë.

Neni 36: “Emërimi i prokurorit të përgjithshëm”.

**Ulsi Manja** – Dakord!

**Fatmir Xhafaj** – Dakord!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Artan Hoxha** – Pra, Kushtetuta, në rregullimin e fundit, thotë se shkojnë tre.

**Fatmir Xhafaj** – Tre kandidatët e renditur më lart në listë.

**Artan Hoxha** – Po. Kështu që duhet hequr “një nga”.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 37: “Betimi”.

**Petrit Vasili** – Ky “Betimi” është shumë i qartë, kur thotë: “Do t’i qëndroj besnik Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi”, Çfarë kuptimi ka kjo: “Do të respektojme rregullat e etikës profesionale”? Nga një nivel kaq i lartë, edhe solemniteti, po të duam, zbresim te rregullat e etikës profesionale.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Prandaj po them pra. Kushtetuta, ligjet në fuqi, kaq është në rregull.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Jo, flitet për etikë profesionale.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo, Kushtetuta përcakton parimet, standardet e përgjithshme. Në Kodin e Etikës ka rregulla të tjera, të cilat janë shumë më të detajuara. Nuk është se shumica e prokurorëve dhe e gjyqtarëve e shkelin Kushtetutën kaq haptas. Ata shkelin etikën profesionale. Sepse në Kushtetutë nuk thuhet: “Mos fol për dosjen! Nxirr sekretin!”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Artan Hoxha** – Unë do të mendoja kështu: meqenëse edhe subjektet e tjera kushtetuese betohen, ndoshta formula mund të jetë e unifikuar, e mund të shohim se si janë projektet e tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, që betohen para Kuvendit, para këshillave.

**Fatmir Xhafaj** – Po, dakord!

**Artan Hoxha** – Një formulë, që të jetë unike.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord!

Keni betimin e Presidentit. Në qoftë se edhe atje ka etikën, e vendosim edhe këtu.

**Artan Hoxha** – Në qoftë se e ka atje etikën. Nëse s’e ka...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Fatmir Xhafaj** – Formula duhet të jetë sa më solemne.

Në rregull. Dakord me nenin 37, me ndryshime.

**Ulsi Manja** – Dakord!

**Fatmir Xhafaj** – Neni 38: “Statusi i Prokurorit të Përgjithshëm”.

**Ulsi Manja** – Dakord jemi!

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull! Dakord!

**Artan Hoxha** – Mundet të jetë pak...?

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Artan Hoxha** – Që të mos jetë nevoja për këtë, me përjashtim të procedurës së vlerësimit profesional, parashikuar në këtë të fundit. Sepse dy ligje janë. S’kemi pse e ndajmë. Është e mjaftueshme që statusi i Prokurorit të Përgjithshëm përcaktohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Pa këtë pjesën mbrapa.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord!

Në rregull! neni 38, dakord me ndryshimet.

E shikoj edhe këtu, te tabela që kanë bërë këta.

Neni 39: “Kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm”.

**Ulsi Manja** – Te neni 39, paragrafi 2, germa “f” është i paqartë formulimi: “cakton sistemin e menaxhimit të çështjeve”.

**Fatmir Xhafaj** – Ku?

**Ulsi Manja** – Te neni 39, paragrafi 2

**Fatmir Xhafaj** – Germa “f”: “Cakton sistemin e menaxhimit të çështjeve”.

**Ulsi Manja** – Po.

**Fatmir Xhafaj** – Çfarë është dashur të thuhet me këtë?

**Artan Hoxha** – Mënyra e shpërndarjes së çështjeve...

**Fatmir Xhafaj** – Ka një sistem elektronik të menaxhimit. Po ai një është. S’ka dy sisteme.

**Artan Hoxha** – Jo, përcakton rregullat. Ka disa rregulla, sepse do të shkojmë më tutje...

**Fatmir Xhafaj** – Po mirë, pra! Atëherë shpreheni qartë: “Përcakton rregullat për zbatimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve”. Sepse po the: “Cakton sistemin, ai do të caktojë cilin sistem do të zgjedhë”, që ta menaxhojë. Një sistem ka. Nuk ka dy sisteme.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Fatmir Xhafaj** – ndoshta s’e kuptoj mirë unë. Tërhiqem. Por na e shpjegoni.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Rakipi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Arben Rakipi** – ...se pse është vënë. Është lënë pak e hapur, sepse ekziston mundësia që sistemi... Domethënë, dy janë sistemet: ai me short, ose sistemi aktual i caktimit të çështjeve nga titullari. Ne i kemi mëshuar idesë se shorti duhet të jetë më i gjerë për t'u aplikuar në prokurori, por kjo kushtëzohet shumë nga fakti nëse numri i prokurorëve është i atillë, që mund ta pranojë shortin apo jo. Në varësi të specializimit të prokurorëve, ekziston mundësia numerike që strukturat e specializuara ta lejojnë shortin. Domethënë, në një prokurori që ka tre vetë, mundet të krijohen seksione. Nëse krijohen seksione, a mund të hidhet short te këta apo jo?

Domethënë, kjo është pamundësia për të përcaktuar shortin në mënyrë definitive.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull! Në qoftë se është i bindur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, rishikojeni atëherë. të ngelet e hapur. Dakord!

Zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – Unë mendoj se kjo pikë ka të bëjë me një qëndrim rast pas rasti, që Prokurori i Përgjithshëm zbaton, sepse, përderisa mund të punojmë me të dy sistemet, pra edhe me short edhe me këtë... Po, në rregull, është korrekt kjo, ne do të themi këtë: “rast pas rasti përcakton sistemin”. Sepse, të thuash: “cakton sistemin” nënkupton se sistemi u caktua dhe është një i vetëm, ndërsa “rast pas rasti” përzgjedh sistemin e administrimit të çështjeve, jo të menaxhimit, por të administrimit të çështjeve. Do të administrohet në këtë mënyrë, me short? Heqim çdo lloj keqkuptimi. Kujtdo që thotë se pse zgjodhi këtë sistem, i japim të kuptojë se për këtë arsye zgjodhi këtë gjë. Po pse zgjodhi këtë gjë? Sepse për këtë arsye zgjodhi këtë sistemi tjetër.

Kështu që, për mua, rast pas rasti, zgjedhja e sistemit të menaxhimit të çështjeve është një përcaktim i qartë e pa ekuivokë.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Arben Rakipi** – Po, domethënë kjo është ideja, që u përmend. Mirë do të ishte që ajo “rast pas rasti” të mos kuptohej sikur po caktohet në ditën kur çështja vjen.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull! Gjenero një formulim, atëherë, që të marrë në konsideratë këtë shqetësim. Mund ta ketë këtë ngarkesë: duket se, kur vjen një çështje e caktuar, ai e cakton për çështjen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull, atëherë, formulojeni!

Zoti Muçmataj.

**Vexhi Muçmataj** – Faleminderit kryetar!

Në pikën 1 thuhet: “Prokurori i Përgjithshëm është drejtues i Prokurorisë së Përgjithshme, dhe ka përgjegjësi për administrimin e punës në administratën e Prokurorisë së Përgjithshme.”. E vijon pastaj. Vetëm për administratën ka përgjegjësi prokurori apo edhe për prokurorët e prokurorisë së përgjithshme? Sepse pastaj vijon: Ka përgjegjësi edhe për prokurorët, pranë prokurorive, në gjykatat e apelit dhe në gjykatat e shkallës së parë. Pra pyetja është: vetëm për administratën e Prokurorisë së Përgjithshme ka përgjegjësi Prokurori i Përgjithshëm, apo edhe për ushtrimin e funksioneve të prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme?

**Artan Hoxha** – Pika 1 ka të bëjë me administratën. Pikat që vijnë më pas përcaktojnë raportet e tjera, që Prokurori i Përgjithshëm vendos me prokurorët, me sistemin e me të gjitha, kurse në rregullimet që vijnë më pas, kur flet për drejtuesin e prokurorisë, ashtu sikurse dhe çdo drejtues i prokurorisë, që ka kompetenca në raport me prokurorët e tjerë, është i përcaktuar edhe Prokurori i Përgjithshëm në raport me prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, por ka një logjikë në këtë që thotë zoti Muçmataj.

E para, sepse nuk mund të fillojë kompetencat e prokurorit me administratën. Kjo nuk bën sens. Figura kryesore i fillon kompetencat me administratën.

E dyta, kur thuhet për menaxhimin e punës në Prokurorinë e Përgjithshme, ke nënkuptuar edhe administratën. Kështu që e heqim fjalën “administratë” dhe mbetet e plotë. Dakord?

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit!

Unë në këtë nen kam një shqetësim për pikën “c” dhe për pikën “f” të paragrafit të dytë. Në pikën “c” thuhet që prokurori i dërgon Ministrisë së Drejtësisë të dhëna statistikore të ndjekjes penale për hartimin e statistikave. Ky formulim nuk është i saktë dhe nuk përputhet me ato kërkesa që ka integrimi europian. Unë do të sugjeroja që të përdoret pak a shumë terminologjia që është përdorur në ligjin “Për qeverisjen” kur flitet për menaxhimin e rasteve, të bëjë një sistem të tillë që të gjenerojë statistikën që tregojnë të dhëna sipas standardeve europiane. Pse e them këtë? UNDCP-ja e ka kritikuar prokurorinë për llojet e statistikave që ajo prodhon. Ne nuk kemi atë që thuhet *track records*. Ne nuk gjenerojmë statistika të cilat na tregojnë se ku janë fillimet, mosfillimet, pezullimet, ku është një çështje, pse është pushuar, në çfarë faze është etj. Të thuash dërgon në Ministrinë e Drejtësisë të

dhëna statistikore është sikur të marrësh një shënues aty të mbledhë disa statistika në eksel dhe t'i çojë.

Prandaj, duke dashur të unifikojmë dhe të përafrojmë legjislacionin me standardet e Kombeve të Bashkuara për statistikat e krimit të Eurostat-it, të Interpolit, të Europol-it, por njëkohësisht edhe me detyrimin që kemi në kuadër të integritit evropian, por dhe për parashikimet që ka bërë ligji për qeverisjen e sistemit të drejtësisë, duhet të ndërtojmë një sistem i cili të gjenerojë statistika në përputhje me standardet evropiane për të gjitha të dhënat. Pra, ta riformulojmë. Po e lexoj. Pra, të ndërtojë një sistem i cili të sigurojë gjenerimin e statistikave që tregojnë të dhënat në përputhje me standardet evropiane të treguesve të të dhënave të futura. Të përpunohen elektronikisht. Nuk mund të vazhdojmë më të kemi përpunime të tilla.

E dyta lidhur me pikën “f” bashkohem me shqetësimin qoftë...

**Artan Hoxha** – Cili nen është ai që ta mbajmë shënim?

**Vasilika Hysi** – Bëhet fjalë për nenin 121 të ligji i qeverisjes.

Gjithashtu unë pajtohem me shqetësimin e ngritur qoftë nga kolegu Manja, qoftë nga kolegu Vasili. Lidhur me menaxhimin e rasteve ne kemi një parim të përgjithshëm të përcaktuar në ligjin “Për qeverisjen e sistemit të drejtësisë”. Ne kemi thënë që këto parime do të zbatohen edhe për rregullat që do të përcaktojnë Këshilli i Lartë i Prokurorisë apo prokurori i Përgjithshëm. Caktim rastesh që një prokuror i përgjithshëm të thotë që këtë rast do të marrë “a”-ja këtë “b”-ja nuk duhet të shkojë. Unë mendoj që duhet të përdoret modeli që është përdorur të ligji “Për qeverisjen e sistemit të drejtësisë”.

**Artan Hoxha** – Te cila pjesë?

**Vasilika Hysi** – Pikërisht po te ky nen, menaxhimi i rasteve. Format i mëparshëm quhej teknologjia e informacionit. Pra, të ketë një sistem të zbatueshëm të menaxhimit të çështjeve dhe të sigurojë një sistem të tillë të vendosur, të jetë transparent, të ketë rregulla të krijimit të funksionimit të tij, të përmirësojë periodikisht. Në këtë mënyrë ne do të shmangim vendosjen ose ndarjen selektive të çështjeve nëpër prokurorë, pavarësisht shqetësimit që ngriti zoti Rakipi në prokuroritë e vogla për të pasur një sistem të menaxhimit të rasteve që ne duhet ta kemi.

**Fatmir Xhafaj** – Ne do të bëjmë një riformulim për t’u mos u kthyer më në këtë gjë. Kurse kjo e inspektimit me thënë të drejtën, në qoftë se ka një gjë, që mua më ka ngelur merak nga kjo pjesa e reformës, është fakti që nuk arritëm asnjëherë të formulojmë diku një zgjidhje që ka të bëjë me shërbimin statistikor. Por besoj se Ministria e Drejtësisë është në momentin e përshtatshëm që me përfundimin e këtij procesi të bëjë atë që nuk e ka pasur



asnjëherë ky vend në 25 vjet, të ketë një shërbim statistikor pranë saj që i gjithë sistemi statistikor të jetë i unifikuar në Shqipëri. Dhe ne sot nuk kemi shërbim statistikor në sistemin e drejtësisë dhe gjenerojmë me mënyra të ndryshme, me modele të ndryshme, me standarde të ndryshme dhe shpeshherë kemi përplasje. Por këtë nuk e zgjidhim dot me këtë ligj, por duhet të bëjmë thjesht një formulim që t'i hapë rrugë pastaj Ministrisë së Drejtësisë të bëjë një reformë të vërtetë në shërbimin statistikor në këtë vend. Dhe këtu Ministria e Drejtësisë në një kohë të përshtatshme duhet ta ideojë dhe ta skicojë një reformë të tillë të sistemit statistikor. Do të ishte një ndihmë e jashtëzakonshme për sistemin. Dakord me ndryshimet.

Vazhdojmë me nenin 40. Zëvendësprokurori i Përgjithshëm.

**Ulsi Manja** – Jam dakord me formulimin që ka neni 40.

**Vasilika Hysi** – Në paragrafin e pestë përdoret termi “pushon së vepruari si prokuror”. Duhet të kem parasysh që shkarkohet apo i mbaron mandati? Sepse “pushon së vepruari” nuk është term.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Hoxha.

**Artan Hoxha** – Termi është për çfarëdolloj arsye pushon së vepruari si prokuror në prokurori. Domethënë që mund të jetë shkarkuar, mund të ketë dhënë dorëheqjen. Ka shumë arsye. Domethënë zëvendësprokurori...

**Fatmir Xhafaj** – Pushon së vepruari...

**Artan Hoxha** – Ky është termi që kemi gjetur. Ndoshta mund të gjejmë ndonjë fjalë tjetër, por...

**Fatmir Xhafaj** – Po që se gjen dhe zonja Hysi një term që ta kënaqë këtë dakord jam.

Neni 41. Buxheti.

**Artan Hoxha** - Ne përveç rregullimit sipas nenit 121 të ligjit tjetër, kuptuam dy gjëra. Kuptuam nevojën që Prokuroria e Përgjithshme të ketë statistikat e veta të unifikuara dhe që kjo kërkon një paragraf. Dhe kuptuam atë që Ministria e Drejtësisë duke qenë autoriteti qendror...

**Fatmir Xhafaj** – Prokurori i Përgjithshëm është i detyruar t'i çojë atje statistikat.

**Artan Hoxha** – Domethënë do të shtojmë dhe një paragraf ne për statistikat që mbart vetë prokuroria.

**Fatmir Xhafaj** – E mbajti besoj shënim këshilltarja dhe jemi dakord.

**Petrit Vasili** – Unë kam një gjë fare të vogël, por që duhet korrigjuar. Kur thuhet se ka një buxhet të pavarur, që përballohet nga buxheti i shtetit. parashikohet në një kapitull të veçantë, nuk janë familjarë në termat e buxhetit. Prokuroria në buxhetin e shtetit financohet

sipas një zëri të veçantë në të. Historia i varur, i pavarur nuk është fare pa kuptim nga ana financiare. E gjithë esenca...

**Fatmir Xhafaj** – Administrimi është i pavarur.

**Petrit Vasili** – Cila është ajo ministri që e ka të varur?

**Fatmir Xhafaj** – Ai ka pavarësi në administrim, por buxhet të pavarur...

**Petrit Vasili** – Por buxheti është një zë i veçantë dhe aty është koncepti që fusim në ligj. Është një zë i veçantë në buxhetin e shtetit.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë duhet riformuluar neni 1 që t'i japë konceptin e qartë jo si buxhet më vete nga buxheti, se një buxhet ka shteti.

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Unë kam një propozim për pikën 2. Ju thoni “prokurori i Përgjithshëm përgatit”. Prokurori i Përgjithshëm nuk e përgatit projektbuxhetin. Në bazë të Kushtetutës, neni 148/b, prokurori i Përgjithshëm propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të prokurorisë së posaçme. Pra, fjala “prokurori përgatit projektbuxhetin” nuk shkon.

**Fatmir Xhafaj** – Bëjeni propozon dhe je në rregull.

**Vasilika Hysi** – Në pikën 5 thuhet se fondet e marra në përputhje me parashikimet e paragrafit 4 të këtij neni duhet të përdoren sipas marrëveshjeve të lidhura me donatorin dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, sepse është dy herë përputhje-përputhje. Unë kam një pyetje, ia shtrova dhe zonjës Koralka, lidhur me rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në Kushtetutë është e vërtetë që prokurorit të Përgjithshëm i është lënë kompetenca të propozojë dhe të administrojë buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të prokurorisë së posaçme. Por, nga ana tjetër, ne në ligjin “Për qeverisjen” kemi lënë që kompetencat e Këshillit të Lartë të Prokurorisë rregullohen sipas të njëjtat rregullave për aq sa është e mundur, kompetencave të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Po shoh Kushtetutën lidhur me kompetencat e Këshilli të Lartë të Prokurorisë dhe ky këshill nuk ka kompetencë ose, e thënë shprehimisht, se çfarë funksione mund të ushtrojë për çështjet e buxhetit. Është thënë vetëm një shkronjë “e” në nenin 149/a, ku thuhet: “Ushtrojnë funksione të tjera të caktuara me ligj”.

Pyetja ime është: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i cili mban përgjegjësi për të gjithë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të një prokurorie, nuk do të ketë absolutisht kompetencë, qoftë edhe të konsultohet, apo të diskutojë për çështjen e buxheteve, me shpërndarjet e tyre, sepse shikoj që Këshillit të Lartë të Prokurorisë i janë lënë dy-tri gjëra dhe asgjë më tepër? E bëj këtë pyetje, pasi ne nesër do të diskutojmë ligjin “Për qeverisjen”.

**Fatmir Xhafaj** – Si gjëra të vogla? Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka gjithë karrierën e prokurorëve, Vasilika, si: vlerësimin, disiplinimin. Si dy-tri gjëra të vogla, sepse i lëshoni fjalët...

**Vasilika Hysi** – Në fakt, po të shikosh ligjin tjetër...

**Fatmir Xhafaj** – Ka të gjithë karrierën e prokurorëve. Cili e vendos karrierën e prokurorëve?

**Vasilika Hysi** – E kanë karrierën dhe propozimet për masat disiplinore.

**Fatmir Xhafaj** – Ç’ të ketë tjetër?

**Vasilika Hysi** – Po në lidhje me buxhetimin, a do të ketë? Për zhvillimin strategjik të institucioneve, a do të ketë?

**Fatmir Xhafaj** – E ka, patjetër. Në Këshillin e Lartë të Prokurorisë shkon ministri i Drejtësisë për strategjinë, e kemi vënë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Dakord, ndryshojeni!

Po i sqarojmë, do të ketë të njëjtat kompetenca që ka Këshilli i Lartë i Gjyqësorit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Nuk e ka në Kushtetutë, nuk ia kemi dhënë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Dakord, do ta kenë aq sa ka në Kushtetutë, të paktën.

**Artan Hoxha** – Kushtetuta ka pasur disa rregullime. Ndërkohë, edhe ne jemi munduar ta ndjekim, aq sa ndiqet ajo. Ndërsa, se cili është rezultati përfundimtar i ligjit “Për qeverisjen”, nuk e dimë si është propozuar nga grupi tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Zoti Vasili, urdhëroni!

**Petrit Vasili** – Kam dy-tri gjëra të tjera për këtë nen.

E para, ky nen duhet sistemuar i tëri në raport me ato që kërkon projektbuxheti.

Termi “përgatit projektbuxhetin” është korrekt. Prokurori i Përgjithshëm nuk propozon projektbuxhet, por përgatit, sepse autoritetin për propozim e ka ministri i Drejtësisë, kështu e ka zgjidhur Kushtetuta.

E dyta, është fare pa kuptim termi që, në rast se propozimi i ardhur nga qeveria është i ndryshëm, prokurori mund të marrë pjesë për mbrojtjen e buxhetit në komisionet përkatëse parlamentare. Nuk ka të thotë, cilido qoftë projektbuxheti që propozohet, në raport me pyetjet apo me interesimin që mund të kenë deputetët, është normale të marrë pjesë dhe nuk është i

kushtëzuar që, në rast se buxheti është ai i propozuari, ai nuk mund të marrë pjesë në parlament, sepse nuk ka logjikë.

Së treti, ne e kemi shumë të qartë legjislacionin, që fondet që përftohen nga marrëveshje, nga donacione të tjera, në çastin e firmosjes ato bëhen pjesë integrale e buxhetit të shtetit dhe auditohen si të tilla, pavarësisht nga forma me të cilën vijnë, dhe në mënyrë normale zbatojnë të gjitha rregullat. Fjalja: “Fondet e marra duhet të përdoren në përputhje me marrëveshjet e lidhura” nuk është në nivelin e ligjit, sepse që ne presupozojmë që prokuroria të marrë disa fonde që mund të mos i përdorë, donatori nuk e di, por këta i vjedhin dhe ia çojnë, këto janë naivitete. Ne qëndrojmë te disa formulime shumë të ftohta që i takojnë projektbuxhetit: ke të drejtën e përgatitjes, të drejtën e mbrojtjes dhe të financohesh me burime të tjera alternative në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rregullat e administrimit të buxhetit nuk i përcakton ky ligj, por ligji përkatës, qofshin fonde, qofshin grante, qofshin kredi të mund të marrë shteti në emër të prokurorisë, sepse mund të ketë nevojë.

**Fatmir Xhafaj - Dakord.**

Unë mendoj se neni 41...

I kam bërë një kërkesë Ministrisë së Financave që ka një drejtori buxheti, dhe i kam thënë: “Kudo që ka dispozita për buxhetin, në të gjitha ligjet, ata duhet të shikojnë një standard që shkon me të gjitha standardet e gjithëpranuara ndërkombëtarisht me praktikë të unifikuar”.

Atëherë, le ta kalojmë nenin 41, por me kushtin që të jetë marrë mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Shtetit, në mënyrë që të kemi një terminologji, një praktikë, e të tjera. Kështu që i kam thënë edhe ministres që ta menaxhoni këtë gjë. Dakord?

**Artan Hoxha** – Në qoftë se mund ta ndihmoj komisionin, është një dispozitë në fund, që janë marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, por i gjithë neni 41...

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Ju lutem, ne e kemi lexuar ligjin, por po flasim si të unifikojmë dispozitat për buxhetin.

Neni 42 “Drejtimi në prokurori”.

Dakord.

Neni 43 “Kompetencat e drejtuesve në drejtimin e prokurorisë”.

**Ulsi Manja** – Jam dakord, nuk kam asnjë gjë për të shtuar.

**Vasilika Hysi** – Unë kam diçka për të shtuar për terminologjinë.

**Fatmir Xhafaj** – E thamë që...

**Vasilika Hysi** – Jo, më falni!

Në nenin 2 të këtij ligji, me termin “përkufizime” kemi thënë kush është prokurori më i lartë, por nuk e gjej përdorimin e termit “prokuror më i lartë”. Meqenëse jemi te kreu “Drejtuesit e prokurorisë”, për të shmangur ndonjë kakofoni, siç thuhet “kompetenca drejtuese në drejtimin e prokurorisë”, është mirë t’i riformulojmë, sepse, kur themi “kompetencat drejtuese të drejtuesit të prokurorisë”, nuk shkon. Ose të heqim edhe përkufizimin që kemi bërë te shkronja “c” e nenit 2 të këtij ligji se kush është prokurori më i lartë dhe pse e kemi sqaruar aty.

**Fatmir Xhafaj** – Aty është për statusin që ai ka në raport me prokurorët e tjerë.

**Vasilika Hysi** – Nuk përdoret asnjëherë.

**Fatmir Xhafaj** – Këtu thuhet “Kompetencat e drejtuesit më të lartë drejtues në prokurori”.

**Vasilika Hysi** – Atëherë, unë jam dakord me këtë. Në qoftë se është thënë se kush është më i larti në hierarki, ta fusim në tekst, ta heqim nga përkufizimet.

**Fatmir Xhafaj** – E ke edhe te përkufizimet.

**Vasilika Hysi** – Është thënë: “Drejtuesi i Apelit është drejtuesi më i lartë në prokurorinë përkatëse. Drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë është prokurori më i lartë”

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, te përkufizimet.

**Vasilika Hysi** – Jo te përkufizimet.

**Artan Hoxha** – Është te përkufizimet se kush janë drejtuesit. Neni 2 thotë: “Prokurori më i lartë është prokurori i Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme, drejtuesi i Prokurorisë së Apelit për këtë, drejtuesi i Prokurorisë së Shkallës së Parë...”

*(Ndërrhyrje pa mikrofon).*

Prandaj bëhet, që të mos thuhet gjithandej.

**Fatmir Xhafaj** – E kemi këtu Vehxhiun sot, ai quhet drejtues prokurorie.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon).*

Është sqaruar kush është titullari, por nuk kanë përdorur fjalën “titullar” por kanë thënë “prokurori më i lartë”, e thënë ndryshe. Pra, do të thoshin ndryshe, siç kemi thënë ne dikur para viteve ’90: “titullari i insionit është ky”, e përdorim shpeshherë edhe sot.

Zoti Muçmataj, urdhëroni!

**Vexhi Muçmataj** – Te neni 43 nuk shikoj asnjë kompetencë të drejtuesit të prokurorisë për sa i takon veprimtarisë funksionale, hetimore dhe operacionale të prokurorisë, që do të thotë se në analizë të fundit lënda e prokurorisë është veprimtaria hetimore,

funkcionale dhe operacionale. Këtu nuk shikoj asnjë kompetencë të drejtuesit të prokurorisë. A ka të drejtë ky të japë urdhër ose udhëzime me shkrim për të plotësuar një hetim? Nuk flas për aktet përfundimtare ose vendimet, ato natyrisht që do t'i marrë prokurori, sepse në rastin më të mirë, një prokuror, për shkak të mungesës së eksperiencës mund të mos e vlerësojë marrjen e një prove, mund të mos vlerësojë bërjen e një kontrolli banese, mund të mos vlerësojë rrethana të tjera të hetimit. Pse duhet të shmanget drejtuesi i prokurorisë në këtë kompetencë?

**Artan Hoxha** – Zoti deputet, kjo është një dispozitë, por janë edhe disa dispozita të tjera që vijnë më pas. Unë mendoj se pyetja e zotit Muçmataj e gjen përgjigjen në... Nëse nuk janë të plota, e shikojmë, sepse janë 5-6 dispozita ose më shumë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, le t'i shikojmë të gjithë kapitujt e më pas, në qoftë se ka...  
(Ndërhyrje pa mikrofon).

**Artan Hoxha** – Nuk ia japim të gjithë zgjidhjen te kjo.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, i ka në nenet e tjera. Në qoftë se nuk i ka, i rikthehem, dakord?

**Petrit Vasili** – Ka dy momente: një moment pa ndonjë rëndësi të madhe, shkronja “d”, që është kompetencë e prokurorëve të organizojnë diskutime për çështje të natyrës juridike.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Petrit Vasili** – Nuk e kuptoj dot, mund ta organizojnë këta për çështje të natyrës mjekësore, apo të natyrës...

**Fatmir Xhafaj** – Po, sepse bëjnë debate profesionale.

**Petrit Vasili** – Debate po, por nuk është kompetencë që mund të jetë pjesë e rutinës së punës, që ne themi se mund të bëjmë mbledhje pune...

**Fatmir Xhafaj** – Po, sepse çfarë ndodh?

**Petrit Vasili** – Kush e pengon ta bëjë?

**Fatmir Xhafaj** – Gjyqtari vetë, për shembull, mund t'i thotë: Nuk dua, sepse nuk e ke ti në kompetencë ta mbledhësh dhe të diskutosh.

**Petrit Vasili** – Organizimet kush i bën?

**Fatmir Xhafaj** – Kryetarët e gjykatave i shmangen shpeshherë kësaj. Po flas për gjykatat, nuk e di për prokuroritë, nuk i njoh mirë.

**Petrit Vasili** – Fatmir, jam dakord me ty, por çfarë është natyra juridike. Në rast se duam ta shmangim të thuhet: Po, me kryetar gjykatash me këtë me këtë, të cilët marrin pjesë.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, jo organizojnë diskutime për çështje të praktikës. Çfarë bëjnë? Vetë prokurorët mblidhen një herë në javë ose një herë në dy javë, prokurorët e prokurorisë së Tiranës nën drejtimin e prokurorit të Tiranës dhe diskutojnë çështje, kazuse, që dalin t'i unifikojnë. Kjo është logjika e kësaj.

**Petrit Vasili** – Më fal, fjala “organizojnë diskutime” me çfarë natyre është diskutimi? Një njeri që e merr ligjin dhe e lexon edhe unë po të dua ta lexoj, thotë: kemi një diskutim, ka dalë një gjë interesante në një revistë juridike italiane për shembull...

**Fatmir Xhafaj** – Për shembull ngre kazuse vetë prokurori. Jam përpara këtij, dua mendimin e kolegëve, si do të rikuptohet kjo në ligj?

**Petrit Vasili** – Nuk jam kundër. Duhet specifikuar se deri ku do të shkojë diskutimi me kë dhe për çfarë qëllimesh kryesore?

Ka një pikë të fundit këtu që thotë “mbajnë kontakte me ekipet audituese të institucioneve të tjera, marrin dijeni për qëllimin dhe objektin e kontrollit dhe u krijojnë kushtet e nevojshme”. Kjo pikë duhet hequr.

Çështjet se cili është raporti i çdo institucioni të shtetit shqiptar me auditimin janë përcaktuar nga ligji i auditit. Këto janë fare të qarta në ligjet e tjera. Është e shkruar që mbajnë kontakt me ekipet audituese të institucioneve të tjera? Cilat janë institucionet e tjera?

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Zoti Hoxha, urdhëroni!

**Artan Hoxha** - Me këtë të fundit jam dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Saktësojeni edhe këtë. Nuk e kundërshton në parim, zoti Vasili. Bie dakord.

**Artan Hoxha** – Kurse “organizon diskutime për çështje juridike” mund të themi “çështje profesionale”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Gjeni një term.

Dakord.

Zonja Hysi, urdhëroni!

**Vasililka Hysi** – Kam një pyetje lidhur me germën “j”. Në germën “j” thuhet që drejtuesi i prokurorisë miraton rregulloren e brendshme për organizimin e funksionimit të prokurorisë dhe në raste të justifikuara përshtat strukturën standarde të miratuar nga prokurori i Përgjithshëm me nevojat e prokurorisë dhe aftësitë e personave në detyrë.”

Çfarë nënkuptoni me “raste të justifikuara” dhe me “aftësitë e personave në detyrë”?

**Artan Hoxha** – Ne themi që krijohen seksione. Me rekomandime zhvillohet veprimtaria kriminale në një zonë të caktuar, në një drejtim të caktuar e kështu me radhë, brenda strukturës, pra, strukturës standard, që miraton prokurori i Përgjithshëm dhe kompetenca që lehtësohet, veprimtaria e vendimmarrjes së brendshme të strukturës së prokurorisë konkrete, pa e prekur standardin e miratuar nga prokurori i Përgjithshëm.

Prokurori titullar ka të drejtë, ne kemi vënë mbledhjen e prokurorëve, të cilët përcaktojnë nëse duhet të krijohen seksione apo struktura. Brenda atyre prokurori titullar ka të drejtë pa prekur standardin, numrin e prokurorëve dhe sipas kapaciteteve të prokurorëve. Për shembull prokurorë të cilët kanë një aftësi në një fushë të caktuar përqendrohen e të tjera me radhë, krijojnë këtë rregullim të brendshëm.

**Vasilika Hysi** - Kur thua “aftësi” kuptohet janë të aftë ose të paaftë.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, jo.

**Vasilika Hysi** – Ndërsa ajo që thoni ka të bëjë me specializimin, kualifikimin e tyre.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, nuk thotë atë, sepse po të them ai ka një strukturë të tij. Ndërkohë, është drejtues prokurorie atje. Ka zëvendësprokuror. Kurse ky këtu bën dy zëvendësprokurorë. Kështu e kuptoj. Ai do ta përshtatë atë.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, këtu thuhet “në përputhje me nevojat e prokurorisë”, e kuptoj shumë mirë shpjegimin e zotit Hoxha. Pra, seksionet që krijohen, tendencat e formave të veçanta të penaltetit dhe aftësitë e personave, nuk e kuptoj. Fjala “aftësi” është individuale, por këtu lidhet me llojet...

**Artan Hoxha** – Ne “aftësinë” në këtë kuptim e kemi. Në qoftë se ju e kuptoni kështu, atëherë ne mund të përdorim një term tjetër. Ne nuk duam të keqkuptohet dispozita. Si thoni “sipas kapaciteteve”?

**Vasilika Hysi** – Në qoftë se nuk ke prokuror të aftë...

**Fatmir Xhafaj** – Nuk është çështja...

**Vasilika Hysi** – Atëherë, do të thuhet “sipas specializimeve dhe kualifikimeve të prokurorëve që ke”.

**Artan Hoxha** – Aftësive dhe specializimeve? Që të kuptohemi.

**Vasilika Hysi** – Aftësitë, jo një herë.

**Fatmir Xhafaj** – Të mos hyjmë në detaje, që i nxjerr edhe praktika.

Zoti Vasili, urdhëroni!

**Petrit Vasili** – Në nenin 44 në germën “dh” kemi thënë: “të garantojnë zbatimin korrekt të udhëzimit të prokurorit të Përgjithshëm”. Kjo është korrekte.



Tani te neni i mësipërm 43, në germën “g” thuhet: “sigurojnë zbatimin”. Të marrin termin “garantojnë” në të gjitha, sepse për të njëjtën gjë një herë themi “sigurojnë”, një herë themi “garantojnë”.

Edhe te neni 43, germa “g” të thuhet “garantojnë”. Ta mbajmë këtë terminologji.

**Fatmir Xhafaj** – Me ndërhyrjen e zotit Vasili duke reflektuar edhe atë që tha zonja Hysi për të gjetur një term të përshtatshëm kalojmë edhe nenin 43 edhe nenin 44. Dakord.

Neni 45. Zëvendësdrejtuesi i prokurorisë.

Dakord.

**Ulsi Manja** – As për nenin 44 dhe as për nenin 45, por do të kërkoja për nenin 44...

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Muçmataj, ju kërkoj ndjesë. Rikthehem në nenin 44.

Urdhëroni!

**Vexhi Muçmataj** – Në nenin 44 germa “ç” në vend të fjalës “sugjeroj” të përdoret fjala “udhëzoj”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 46.

**Ulsi Manja** – Dakord për nenin 46.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, kam diçka për nenin 45 te vlerësimi. Më duhet ta unifikoj edhe me...

**Fatmir Xhafaj** - Po, pra ramë dakord.

**Vasilika Hysi** – Jo, jo, ju thoni që të zgjidhesh zëvendësdrejtues i një prokurorie duhet të jesh vlerësuar shumë mirë në tri vlerësimet e fundit të performancës. Lidhur me vlerësimet ne kemi vënë afate të ndryshme te statusi i gjyqtarit dhe prokurorit.

**Fatmir Xhafaj** – Ne ramë dakord t’i unifikojmë këto gjëra.

**Vasilika Hysi** – Po nuk shkon kriteri “të vlerësohet shumë mirë në tri vlerësimet e fundit” dhe, nga ana tjetër, duhet të ketë 5 vjet.

Ne kemi një vlerësim të përvitshëm të prokurorit? Ne nuk na rezulton të kemi një vlerësim të përgjithshëm të prokurorit, sipas ligjit për statusin e prokurorit dhe të gjyqtarit.

Nga ana tjetër, duke vënë si kriter që mund të bëhesh zëvendësdrejtues i prokurorisë kur në 5 vjet je vlerësuar tri herët e fundit, tregon që ke pasur një vlerësim të përvitshëm. Këtë duhet ta unifikojmë.

**Fatmir Xhafaj** – Unifikojeni si janë dy ligjet. Të mos e zgjasim.

**Vasilika Hysi** – Përndryshe këtu ndryshon kriteri.

**Fatmir Xhafaj** – Ramë dakord me këtë gjë.

**Artan Hoxha** – Vetëm një gjë mund të mos jetë 3, mund të jetë 2.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, nuk ka me mund. Do t'i unifikoni që të mos kemi një aty e një atje. E mbajtët shënim?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Neni 47. Udhëzimet e përgjithshme.

**Ulsi Manja** - Neni 47, paragrafi 2 ne bëjmë një riformulim dhe sugjerojmë të hiqet fjala “ kryesisht” dhe të thuhet “ udhëzimet e përgjithshme sipas këtij neni mund të jenë të natyrës administrative ose proceduale.”

Në nenin 47 pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje dhe prokurori mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme. Tani e kam si shtim paragrafi, por më tepër dua edhe të pyes: A është e nevojshme ta detajojmë natyrën e udhëzimeve të përgjithshme që nxjerrë prokurori i Përgjithshëm në ligj?

Pra, a ka nevojë të detajohet natyra e udhëzimeve të përgjithshme që nxjerr prokurori në ligj apo jo?

**Artan Hoxha** – Kur kemi diskutuar në parim, pyetja e parë që erdhi nga ju ishte: Të cilës natyrë do të jenë këto udhëzime të karakterit të përgjithshëm dhe që kanë efekte detyruese për prokurorin?

Nëse ne do ta lëmë të hapur të papërcaktuar në ligj, atëherë kemi rrezikun që prokurori i Përgjithshëm të nxjerrë udhëzime të karakterit të përgjithshëm, të cilat janë detyruese edhe për gjëra që mund të tejkalojnë autoritetin e tij si prokurori e decentralizuar.

Ne mendojmë se është korrekte që, duke dashur të ruajmë pavarësinë e prokurorisë, të prokurorëve, por duke dashur, nga ana tjetër, që prokuroria të funksionojë si strukturë, atëherë prokurorit të Përgjithshëm, që nuk e kemi pasur me këtë propozim, siç e kemi sot, t'i lëmë disa autoritete, por autoritete të kontrolluara nga ligji. Nëse ne nuk i themi në ligj se cilat janë udhëzimet, cila është natyra e udhëzimeve të karakterit të përgjithshëm dhe që janë detyruese, atëherë mundësia që të abuzohet me këtë, do të jetë e madhe.

Ne jemi munduar të përcaktojmë se cilat janë kategoritë e atyre udhëzimeve, të cilat prokurori i Përgjithshëm i nxjerr dhe që kanë efekte detyruese për të gjithë sistemin. Kjo është korrekte dhe i përgjigjet edhe Kushtetutës dhe, gjithashtu, garanton funksionimin e strukturës dhe pavarësinë e prokurorëve. Më pas, në dispozitat e projektligjit është përcaktimi i rregullave të karakterit të përgjithshëm, që vijnë nga drejtuesi, që është kryesisht prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i prokurorisë. Këto rregulla janë të detyrueshme dhe quhen “udhëzime të përgjithshme të detyrueshëm”. Më pas kemi udhëzimet e drejtuesve për çështjet konkrete, të cilat nuk kanë karakter detyrues, por ndihmojnë në veprimtarinë e prokurorisë në ushtrimin e funksioneve të veta. Në këtë pikëpamje duhet të përcaktohet se cili është

karakteri detyruës, në cilat fusha prokurori i Përgjithshëm do t'i nxjerrë. Kjo duhet të thuhet në ligj, sepse nuk e bën vetëm prokurori i Përgjithshëm, por e bën edhe drejtuesi i prokurorisë, për aq hapësirë sa i lejon ligji. Po nuk u tha në ligj, atëherë rreziku që prokurori i Përgjithshëm ose drejtuesi i prokurorisë të nxjerrë udhëzime të karakterit të përgjithshëm detyruës, pafundësisht dhe abuzivisht, me riskun që të prekë Kushtetutën, do të jetë i madh.

**Ulsi Manja** – Kam edhe një pyetje në lidhje po me këtë nen. Në pikën 3 thuhet: “Udhëzimet e përgjithshme të prokurorit të Përgjithshëm do të botohen në Fletoren Zyrtare”.

**Fatmir Xhafaj** – Jo vetëm në Fletoren Zyrtare, por duhen botuar edhe në faqen zyrtare.

**Ulsi Manja** – Po. Në pikën 4 thuhet: “Duhen publikuar edhe në faqen e internetit të prokurorisë”.

**Fatmir Xhafaj** – Po, dakord, por edhe udhëzimet e përgjithshme të prokurorit, sepse pika 4 është për drejtuesit e prokurorive.

**Ulsi Manja** – Firmosja e një akti me karakter të përgjithshëm nga ana e prokurorit të Përgjithshëm dhe, sigurisht, momenti i firmosjes së një udhëzimi me karakter të përgjithshëm të prokurorit të Përgjithshëm, u shkon të gjitha prokurorive dhe botohet edhe në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme, ku kanë akses të gjitha prokuroritë. Pyetja ime është: në cilin moment do të konsiderohet se hyn në fuqi ky udhëzim me karakter të përgjithshëm? Sepse ai vendos norma detyruese për sferën që mbulon ky akt i prokurorit të Përgjithshëm. Cili do të jetë momenti, pra efekti i botimit në Fletoren Zyrtare? lidhet me momentin e hyrjes në fuqi të udhëzimit, apo hyn në fuqi në momentin që firmoset dhe prokurorët kanë akses mbi këtë udhëzim?

**Artan Hoxha** – “...meqenëse nuk ka rregullim ligji”, do të thotë të shkojmë me rregullat e përgjithshme, që marrin efekt 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Fatmir Xhafaj** – Çfarë ju kushton ju ta përcaktoni këtë gjë?

**Artan Hoxha**- Po, edhe mund ta përcaktojmë.

**Fatmir Xhafaj** – Po, përcaktojeni, kur e keni mundësinë! Ne po bëjmë ligjin, kurse ju thoni: “...meqenëse nuk e ka përcaktuar ligji”, por ne ligjin po bëjmë.

**Arben Rakipi** – Zoti kryetar, çështja e udhëzimit të prokurorit të Përgjithshëm nuk ka fuqi detyruese për qytetarët; është thjesht një element disiplinimi i punës së prokurorëve. Fuqia detyruese e udhëzimit të prokurorit të Përgjithshëm, është shumë relative, kështu që çështja e hyrjes ose jo në fuqi të udhëzimit, nuk ka asnjë lloj interesi për qytetarët e thjeshtë. Madje, nuk ka asnjë lloj interesi edhe për vetë gjykatën. Ky është thjesht një element autoriteti profesional i titullarit, i cili kërkon të mbajë në vathë nëpunësit e tij. Kështu që

çështja: hyri apo nuk hyri në fuqi, nuk i duhet askujt, përveçse prokurorit të çështjes për t'u konsideruar nëse do t'i bindet urdhrorit të titullarit ose jo. Është e thjeshtë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, por kjo krijon një efekt.

**Arben Rakipi** – Efekti që krijon është për të ardhmen, megjithatë ...

**Fatmir Xhafaj** – Vendosni një afat, që nga ky moment, sepse mund të ketë norma që kur...

**Arben Rakipi** – Nuk është akt normativ, në kuptimin e vendosjes së rregullave për sjelljen e të qytetarëve.

**Fatmir Xhafaj** - Por është për prokurorët dhe një prokuror thotë: nuk ka hyrë në fuqi, tjetri thotë..., pra vendosni një afat. Çfarë ju kushton të vendosni një afat?

**Arben Rakipi** – Ne nuk na kushton asgjë, por...

**Fatmir Xhafaj** – Bëhet e detyrueshme, sepse besoj se ato kanë një sanksion në qoftë se nuk zbatohen; është shkelje disipline nëse ai nuk i zbaton. Atëherë, përderisa ka një element detyrues, caktoni një afat, momentin e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Petrit Vasili** - Kam një koment shumë të shkurtër.

Çdo veprim që prokurorët bëjnë apo nuk bëjnë, e bëjnë në kohë apo nuk e bëjnë në kohë, zoti Rakipi, ka efektin te qytetarët. Këta nuk janë një sekt që punojnë brenda vetes së tyre: punuan mirë apo punuan keq. Secili ka një çështje të një qytetari në dorë, nuk ka një çështje të vetën të brendshme. Unë nuk jam dakord me ideja që të mos prodhojë efekt te qytetarët. Po të mos prodhojë efekt te qytetarët dhe po të mos ketë asnjë interes, nuk duhet të publikohet në faqen zyrtare në internet; duhet të jetë i brendshëm, i mbyllur, komplet i padukshëm.

Pra, qëndrimi në raport me këtë çështje është se ka interes të madh për qytetarët, sepse ai veprim lidhet me punën e prokurorit, po një qytetar ka edhe një avokat nga pas, që është i lidhur me mënyrën si do të veprojë prokuroria, kështu që unë ndaj një opinion të ndryshëm nga juaj lidhur me kanë apo nuk kanë raport me qytetarët. Çdo element që ka të bëjë me një çështje të caktuar prokuror, avokat, gjykatës janë të gjitha çështje që kanë të bëjnë me qytetarët. Prandaj, ne po japim këtë shkallë transparence, precizim të lartë, afate e të tjera, me qëllim që kushdo të ketë mundësinë të shikojë që kjo veprimtari është e normuar, ka rregulla dhe ka mundësi të kontrollohet, prandaj nuk duhet ta shikojmë në këtë mënyrë.

**Fatmir Xhafaj** – Vendosim një afat këtu.

Dakord, miratohet neni 47, me ndryshimet e propozuara nga relatori dhe nga ato që u thanë këtu.

Neni 48: “Kundërshtimi i udhëzimeve të përgjithshme”

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Petrit Vasili** - Kam unë një vërejtje për nenin 48.

Neni 48 ka dy pika, njëra është e qartë, njëra e paqartë.

Në pikën e parë thuhet: “Prokurori mund të shtojë paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e udhëzimeve të përgjithshme, duke bërë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”, kjo është korrekte, pra konstaton një fenomen që i jepet e drejta të ankimohej, ndërkohë i jepet e drejta, të bëjë edhe vetëgjyqësi, pasi thuhet: “...është i detyruar të ndjekë udhëzimet e ankimuara”, pra do të vazhdojë t’i zbatojë deri në momentin, kur ankimi i tij të ketë marrë një përgjigje, me përjashtim të rastit kur vlerëson ai vetë se janë haptas në kundërshtim me ligjin, por ky këtë raport e ka ndërtuar, sepse është ankuar. Në rast se ia japim këtë gjë, nuk ka pse të ankohej. Ne po themi që sa herë ai ta gjykojë të arsyeshme që nuk janë të bazuara, ai nuk pyet fare dhe nuk i zbaton. Kjo krijon një kaos të madh.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Hoxha.

**Artan Hoxha** – Unë, personalisht, do të thosha se paragrafi i dytë nuk është i nevojshëm.

**Fatmir Xhafaj** – Më fal, por paragrafin e dytë nuk e kam shkruar unë, e ke shkruar ti.

**Artan Hoxha** – Jo, me këtë arsytim ...

**Fatmir Xhafaj** – Jo, që të kuptohemi se duket sikur e ka shkruar një i tretë dhe ...

**Artan Hoxha** – Jo, jo, unë pranova arsyetimin dhe thashë...

**Fatmir Xhafaj** – Pra, ju bini dakord që kjo të hiqet, sepse kështu duket sikur e ka shkruar një tjetër.

Unë jam dakord vetëm për një arsye, sepse këto janë të karakterit me udhëzime të përgjithshme dhe ndjek linjën e zotit Rakipi, që nuk krijojnë ndonjë efekt dhe nuk ka pse të ketë...

**Arben Rakipi** – Tani ndoshta duhet të hyjmë në detaje, që të jem edhe unë i kuptueshëm në atë që them dhe të moskeqkuptohem. Pra, nga udhëzimet e përgjithshme nuk do të ndodhë asnjë alternativë nga ato që përmendi zoti Vasili, sepse udhëzimet e përgjithshme nuk lidhen me çështje konkrete.

Udhëzimet e përgjithshme janë të këtij karakteri që, për shembull, prokurori i Përgjithshëm vlerëson që çështjet e vjedhjes së energjisë elektrike, meqenëse është një gjë masive, të mos dënohen me burg dhe orienton prokurorët të shikojnë mundësinë që këto çështje të mos dënohen me burg, gjoba mund të jetë një dënim më efikas.

**Fatmir Xhafaj** – Besoj se për të dytën edhe ju bini dakord, që nuk duhet të jetë, apo jo? Sepse nuk ka efekt te çështja konkrete.

**Arben Rakipi** – Jo, unë nuk jam për atë, sepse koncepti që shprehet në pikën 2 është një koncept që njihet nga ana jonë në ligjin penal, “kur urdhri është haptazi i paligjshëm, nuk zbatohet, e kështu me radhë, kështu që si koncept ai duhet të jetë, e para. E dyta...

**Fatmir Xhafaj** – Këto janë udhëzime me karakter të përgjithshëm, nuk janë për çështje konkrete.

**Arben Rakipi** – Prandaj po them që duhet, sepse neve asgjë nuk na garanton që një udhëzim mund të jetë edhe i posaçëm. Mund të lajthisin titullarët, mund të japin një udhëzim me karakter të posaçëm për një çështje konkrete dhe prokurori i çështjes duhet të reagojë.

**Fatmir Xhafaj** – Kur reagon, shkon në Këshillin e Lartë.

**Arben Rakipi** - Ndodh eventualiteti që edhe këshilli e mbështet.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë, mbaroi, pastaj ai mbetet në fuqi.

**Arben Rakipi** – Si koncept ne e kemi të njohur, por, po që se ju mendoni se do të anojë më tepër nga abuzimet e prokurorit individual, unë pikën 2 e konceptoj si një garanci për prokurorin individual.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord po të jetë “e posaçme”, unë do të bie dakord me ju.

**Arben Rakipi** – Po, mund të jetë.

**Fatmir Xhafaj** – Po nuk është e posaçme, se ju keni thënë: “Udhëzime të përgjithshme”.

**Arben Rakipi** – Po marr alternativën që devijoi prokurori titullar, në një moment të caktuar lëshoi një udhëzim, i cili nga natyra e tij dhe nga koha kur jepet nga rasti që ...

**Fatmir Xhafaj** - Do të shkojë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Nëse Këshilli i Lartë thotë: dakord, çfarë do të thotë prokurori; nuk e zbatoj se është e kundërligjshme?

**Arben Rakipi** – Prokurori i çështjes edhe mund të mos e zbatojë.

**Fatmir Xhafaj** – Nëse shkon në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, vendos dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Kush e zgjidh këtë?

**Arben Rakipi** – Ta zgjidhë prokurori i çështjes. Ne kemi standardin që edhe një ushtar, edhe një qytetar, edhe një polic “urdhrin haptazi të paligjshëm”, nuk duhet ta zbatojë. Këtë standard e kemi, po, nëse ky standard nuk mund t’i lihet prokurorit për t’u zbatuar...

**Fatmir Xhafaj** – Edhe një herë, por ama ka një të drejtë se diku do ta ankimojë. Nëse organi ku e ankimon shprehet përsëri në favor të udhëzimeve të përgjithshme, çfarë do të thotë prokurori, se pastaj mbetet kaotike, që unë kur dua, e zbatoj, kur nuk dua, nuk e

zbatoj, sepse koncepti im është që ky është i kundërligjshëm. Kjo krijon një lloj kakofonie në këtë sistem.

**Arben Rakipi** - Këtu mund ta krijojë atë që thoni ju dhe dyshimet mund të shkojnë në të gjitha anët, por unë mbroj konceptin: përderisa ne mbrojtjen nga veprimi haptazi i paligjshëm, nga urdhri haptazi i kundërligjshëm e kemi të pranuar, nuk shoh asnjë arsye që prokurori të mos e ketë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, për sa kohë që të mos shkonte në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, unë do të thosha: dakord, është një mundësi që mund të ndodhë kjo, por sa kohë që kemi një organ kolegjal që qeveris të gjithë sistemin dhe vendos në mënyrë kolegiale ...

**Arben Rakipi** - Meqenëse këtë çështje ne po e shohim në themel, kërkoj ndjesë, që po refuzoj nenin 48, edhe për një arsye tjetër. Më falni, se nuk dua të konfrontohem me atë që e ka shkruar, por Këshilli i Prokurorisë nuk ka punë fare me këtë çështje, sepse ai është një organ administrativ dhe për çështje procedurale nuk duhet të impenjohet, nuk duhet ne ta impenjojmë. Këtu bëhet fjalë për një konflikt midis titullarit dhe vartësit dhe ky konflikt procedural duhet të gjejë një zgjidhje procedurale. Nuk mund të çohet në Këshill, sepse Këshilli nuk është organ procedural.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe një herë, ky nuk është udhëzim i posaçëm, po të ishte i tillë, për çështje konkrete, unë do të bija dakord me ju që nuk ka punë këshilli, por, nëse është një udhëzim me natyrë të përgjithshme apo akt normativ me natyrë të përgjithshme, atëherë Këshilli ka të drejtë, sepse cakton norma sjelljeje.

**Arben Rakipi** - Procedurë është edhe ajo.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord pra, por diku do të ankohet ky, se nuk mund edhe ta lëmë kështu që ai cakton një gjë dhe unë nuk e zbatoj udhëzimin me natyrë të përgjithshme. Po të ishte i natyrës së posaçme, jam shumë dakord me ju.

**Arben Rakipi** – Në të gjithë këtë histori unë kam pasur tendencë jo vetëm në këtë historinë e reformës, por gjatë gjithë jetës sime kam pasur tendencën që individi duhet të jetë i lirë dhe prokurori duhet të jetë i lirë, sigurisht disa mekanizma kontrolli duhet t'i ketë.

**Fatmir Xhafaj** – Prandaj pra, udhëzimi i përgjithshëm është një mekanizëm, një kornizë ku ai duhet të silllet brenda ...

**Arben Rakipi** – Asnjë nga ne nuk jep garanci për këtë, sepse mund të jetë edhe individual, ose mund të fshihet pas të përgjithshmit, por dita kur del, natyra që ka, efekti që ka lidhet me çështje konkrete. Prokurori i çështjes duhet të ketë mekanizëm për t'u mbrojtur.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Unë them që është e panevojshme, gjithsesi, le të mbetet ta diskutojmë me ekspertët ndërkombëtarë, ta lëmë të hapur, por të lutem, të mos e zgjasim më këtë.

**Petrit Vasili**-Unë dua të qëndroj një minutë këtu, për të tjerat pak debat kemi. Problemi është i tillë, prezumimi që ne kemi individë shumë të mirë, të pagabueshëm dhe drejtues, të cilët janë të gabueshëm, të ngarkuar me të gjitha mundësitë e korrupsionit dhe të ndikueshmërisë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Ju lutem, ta mbaroj fjalinë, ju paraqitët qasjen tuaj, unë kam timen.

Unë mendoj se e gjithë kjo reformë që bëjmë rrit maksimalisht integritetin e drejtuesve të lartë të prokurorisë. Prandaj e kemi rireformuar sistemin, prandaj kemi bërë një sistem vlerësimi shumë rigoroz.

Ideja që individit ka mitin e pagabueshmërisë, duke qenë në detyrë shtetërore, dhe liria e tij lidhur me të janë dy lidhje të ndryshme. Është tjetër liria e individit në jetën e tij të zakonshme private, tjetër liria e individit në detyrë. Janë dy koncepte që, kur përzihen me njëri-tjetrin, na sjellin në këtë debat të panevojshëm që po bëjmë sot.

Individi në detyrë ka kornizat ku vepron, ka rregullat dhe udhëzimet që merr, të cilat kanë lindur në bazë të integritetit të institucioneve që ndodhen mbi të. Premisa që kemi institucione të dobëta të ndërtuara keq, por kemi individin e fortë që e mbron këtë gjë, kjo është kundër sistemit të kësaj reforme që ne po bëjmë. Nëse këtë reformë e bëjmë mbi këtë premisë, ne nuk kemi absolutisht asgjë, por prapë po rindërtojmë një kokë të kalbur por me idenë që kemi një bazë të shëndoshë.

Këto lloj iluzionesh dhe këto lloj paragjykimesh shumë të thella konceptuale unë i refuzoj Kjo dispozitë më shumë se çdo gjë tjetër kishte vlerë diskutimi, unë e kuptoj zotin Xhafaj, sepse diskutimi u zgjat shumë dhe duhet të fitojmë kohë, por në këtë rast është për të vënë gjërat njëherë mirë në vend, për të ditur se mbi ç' frymë diskutojmë, mbi këtë frymë apo mbi këtë frymën tjetër. Unë jam i idesë që sistemi që po ndërtojmë është një sistem me integritet, por, nëse është i tillë me këto lloj kundërthëniesh dhe kontradiktë të madhe që ka, atëherë ne jemi në rrugë të gabuar.

**Korajlka Bumçi** – *(flet anglisht)* Mund të shtoj diçka. Mendoj se është shumë e rëndësishme që të qëndrojmë në paragrafin e dytë, ku prokurori, i cili kundërshton udhëzimet, nuk mund të konsiderohet përgjegjës. Ne mund ta riformulojmë, mund ta pasurojmë paragrafin, por nuk mendoj se është shumë e mençur që ta heqim të gjithin si paragraf. Mendoj se është gjë e mençur ta kemi këtë si paragraf. Por, sigurisht, është detyrim për



prokurorin, i cili duhet të ndjekë disa rregulla të caktuara, ai thjesht nuk mund t'i sfidojë, t'i kundërshtojë udhëzimet për hir të të kundërshtuarit të ato, sepse mund të keni një prokuror ose një personalitet, i cili mund të gjendet para një sfide të tillë. Pra, ndoshta duhet të bëjë një formulim tjetër për të garantuar pavarësinë e kështu me radhë.

**Fatmir Xhafaj** – Ju përgatiteni dhe silleni, por, më vjen keq që kërkoj mirëkuptimin, nuk jam dakord me ju për një gjë të thjeshtë, sepse këto janë udhëzime me natyrë të përgjithshme. Ai shkon ankohet në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ju e keni vendosur këtu, nuk e kemi shkruar ne që duhet të ankohet në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Në momentin që merr vendim Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ai është i detyruar që ta zbatojë, sepse ndryshe pastaj nuk është korrekte, sepse prokurori nxjerr një udhëzim, nuk e zbaton, nuk është dakord, e ankimon, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pastaj hajdeni të vëmë edhe gjykatën, por ama duhet të ketë një kufi, që duhet të jetë detyruese norma e përgjithshme, pastaj është normë e përgjithshme, është orientuese. Dakord, silleni një herë formulimin.

Po zoti Smibert.

**Jon Smibert** – (*flet anglisht*) Thjesht do të doja të shtoja shkurtimisht se ajo që bëjmë kryesisht është që edhe në udhëzimet e përgjithshme që japim si të interpretojnë atë çfarë është sjellë në gjykatë, për shembull, nëse na vendos në një vështirësi morale, kemi mundësinë që ta kundërshtojmë këtë gjë dhe më pas ajo mund të kalojë edhe në departamentin e drejtësisë, bëhet një vendim institucional pra këtu është e drejtë që prokurori të mos jetë i detyruar ta bëjë këtë gjë deri sa të merret si vendim institucional. Jam dakord me Korën që mund të formatohet paksa, por mendoj që në këtë sistem për shumë njerëz kjo mund të jetë mundësi për të mos bërë diçka.

**Fatmir Xhafaj** – Meqenëse ju kërkuat një riformulim, po ju japim mundësinë që ta bëni dhe ralatori të jetë i vëmendshëm për këtë.

Neni 49 “Udhëzimet për çështje konkrete”? Dakord.

Neni 50 “Zëvendësimi i prokurorit”?

**Ulsi Manja** - Te neni 50, pas paragrafit të dytë ne sugjerojmë të shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje: “Drejtuesi i prokurorisë merr vendim me shkrim lidhur me zëvendësimin e prokurorit. Vendimi për tërheqjen e çështjes i dorëzohet prokurorit përkatës, dhe prokurori ka të drejtën të paraqesë ankim me shkrim kundër vendimit të zëvendësimit në rastet e parashikuara në paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni. Vendimi me shkrim dhe ankimi përkatës janë pjesë e dosjes”.

Pas paragrafit 3 të shtohet një paragraf i katërt me këtë përmbajtje: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen rregullisht të paktën çdo vit një inspektim tematik mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 50 me propozimet dhe ndryshimet e bëra.

Neni 51 “Raportimi vjetor te prokurori i Përgjithshëm”.

**Ulsi Manja** – Dakord me ato sugjerime që janë të natyrës së teknikës legislative. Në përmbajtje nuk kemi ndonjë kundërshtim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 52 “ Marrëdhëniet me publikun”.

**Ulsi Manja** - Neni 52 sugjerohet të kalojë si nen në kreun 7, seksioni i parë, 59/c.

**Fatmir Xhafaj** – Po, dakord. Zhvendosje është dhe të bëhet riformulimi te pika 2.

Neni 53 “Shmangia e konfliktit të interesit”. Jeni dakord me korrigjimet dhe redaktimet?

**Ulsi Manja** – Dakord për nenin 53.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimet e paraqitura këtu? Okej, dakord.

Neni 54. Dakord.

Neni 55.

**Ulsi Manja** – Në lidhje me nenin 55, pika 1, fjalia e parë duhet të përcaktojë shprehimisht llojin e aktit nëpërmjet të cilës prokurori i Përgjithshëm duhet të përcaktojë rregullat e parashikuara në vijim dhe afatin me hyrjen në fuqi të ligjit.

Në nenin 55, pika 1 gërma “a”, të hiqet fjala “të mjaftueshme”, pra në nenin 55, jemi dakord me sugjerimet përkatëse.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me sugjerimet. Faleminderit!

Neni 56 “Mbledhja e prokurorëve të prokurorisë së Përgjithshme”.

**Ulsi Manja** – Dakord jam me nenin 56. Nuk kam sugjerime.

**Fatmir Xhafaj** – Kam qenë dhe jam kundër për “vendosjen”. Mbledhja e përgjithshme nuk merr vendim. Ajo është mbledhje konsultative, që konsultohet, njeh shumë mirë. Si gjetje është gjetje shumë e mirë, por nuk është një institucion vendimmarrës dhe këto dy funksione do t’i kalojnë “b”-ja dhe “ç”-ja edhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Pra, jemi dakord me nenin 56.

Kam një gjë për të sqaruar, ku i paraqet ministri i Drejtësisë politikat e qeverisë në luftën kundër kriminalitetit? E keni përcaktuar?

**Artan Hoxha** - Është një dispozitë në fund.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, të mbahen në konsideratë deri në momentin kur të arrijmë tek ai kapitull.

Neni 57. Dakord.

Neni 58.

**Ulsi Manja** –Dakord me nenin 58.

**Fatmir Xhafaj** – Por jo me procesin vendimmarrës. Kjo s'ka vendimmarrje, kështu që duhet ta rishikoni.

**Ulsi Manja** - Natyrisht, mbledhja e përgjithshme e prokurorëve në të gjitha nivelet që parashikohet, nuk duhet të jetë e natyrës vendimmarrëse proceduriale, në gjykimin tim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Duhet reflektuar edhe te neni 58.

**Artan Hoxha** - Jemi te procesi vendimmarrës, te mbledhja e përgjithshme prokurorëve? Kjo dispozitë është?

Atëherë, a mund të bëjmë një rregullim te pika 4?

**Fatmir Xhafaj** – Ramë dakord që nuk do të jenë të natyrës vendimmarrëse.

**Artan Hoxha** -“Në raste të veçanta, me kërkesë të çdo anëtari, hiqet kjo “dhe me vota të përgjithshme të anëtarëve”, mbledhja mund të diskutojë dhe të marrë vendime për çështje që lidhen me rendin e ditës”.

**Fatmir Xhafaj** - Po, dakord me ndryshimet.

**Artan Hoxha** – Edhe pesa, ne kemi dashur të jemi eksplicitë, por nuk është nevoja që “mbledhja e prokurorëve regjistrohët”, mund të them për procesverbalet...

**Ulsi Manja** – Në qoftë se për pikën 5 vlen të bëjmë ndonjë rregullim, vendosja e detyrimit për publikimin në faqen zyrtare të prokurorisë, ndoshta është e tepërt.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë i rishikoni të gjitha këto ndryshime që thamë. Dakord.

**Artan Hoxha** – Ne e kemi pasur që të votojmë vetëm vendimet, por jo proces verbalet.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimet te neni 58.

Neni 59 “Struktura e prokurorisë”.

**Ulsi Manja** – Jam dakord me strukturën. Nuk kam sugjerime.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 59.

**Artan Hoxha** – Për nenin 58 u ra dakord me ndryshimet se nuk e kuptova?

**Fatmir Xhafaj** – Po patjetër, me ndryshimet që u thanë u ra dakord që relatori bashkë me ju ta rishikoni dhe këshilltarja ta ndjekë që më pas të më raportojë dhe ta shohim të reflektuar përpara miratimit në tërësi.

Mbas nenit 59, shtohet 59/a, 59/b, 59/c, 59/ç, 59/d, 59/dh, 59/e, dhe 59/h si më poshtë: “kancelari”, kancelar do të jetë ky? Pak a shumë është bërë me ligjin “Për organizimin gjyqësor”, kështu që mund t’i kalojmë shpejt këto.

Dakord me nenin 59/a me ndryshime teknike që janë pasqyruar këtu.

Me nenet 59/b, 59/c, 59/ç, 59/d, 59/dh “Rregulli dhe siguria”, dakord me ndryshimet.

**Artan Hoxha** – Te neni 59/dh “Rregulli dhe siguria”, ta ndryshojmë “Rendi dhe siguria” dhe rregullohet..

**Fatmir Xhafaj** – Po, dakord me ndryshimet, meqenëse janë redaktoriale.

**Fatmir Xhafaj** - Vazhdojmë me nenin 60 “Statusi i personelit të prokurorive”.

**Ulsi Manja** – Lidhur me nenin 60, parashikimi i paragrafit 3 nuk ka lidhje me titullin e këtij neni dhe duhet të kalojë në nenin që trajton statusin e prokurorëve, sepse flet për statusin e prokurorëve të...

**Fatmir Xhafaj** – Këtu, në nenin 60, thuhet: “Statusi i personelit të prokurorive”.

**Ulsi Manja** – Po, pra, flet për statusin e personelit të prokurorive, ndërkohë që paragrafi i tretë flet për statusin e prokurorëve të komanduar. Pika 3 e nenit 60 thotë: “Statusi i prokurorëve të komanduar përcaktohet në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, nuk ka lidhje me titullin e nenit, sepse titulli i nenit është “Statusi i personelit të prokurorive”, nuk qëndron këtu në këtë nen.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, shiheni atëherë.

**Ulsi Manja** – Duhet të kalojë tek ajo që trajton statusin e...

**Artan Hoxha** – Është gabimisht këtu, sepse në fakt është te dispozita më poshtë.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

**Artan Hoxha** – Është te neni që vjen më pas.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 60 me reflektimin. Dakord?

**Artan Hoxha** – Shkon si paragraf i fundit i nenit tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 61, “Praktikantët në prokurori”.

**Ulsi Manja** – Lidhur me praktikantët në prokurori do të doja një shpjegim pak më të qartë se cilat do të jenë detyrat dhe funksionet e këtyre praktikantëve, sepse është një term i ri dhe kemi rënë dakord që të ketë një unifikim të këtyre termave që përdoren në të gjitha këto ligje dhe termi “Praktikant në prokurori” është...

Pra, do të doja një shpjegim më të hollësishëm, sepse do të kemi edhe magjistratë në praktikë.

**Fatmir Xhafaj** – A mund ta shikoni këtë me ligjin “Për statusin e gjyqtarëve”? Në rregull.

**Ulsi Manja** – Me statusin e gjyqtarëve.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

**Artan Hoxha** – Me këtë është e unifikuar ajo, ata që vijnë dhe që punojnë...

**Fatmir Xhafaj** – Me atë ligj duhet të unifikohet, pra duhet të punoni me kolegët tuaj...

**Ulsi Manja** – Dakord, duhet ta shohim me atë ligj.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 61. Dakord.

Pas nenit 61 shtohet fjala që u miratua me ndryshime për t’u përjasur edhe me ligjin “Për statusin”, shtohet fjala “Seksioni 2”, si më poshtë. “Seksioni 2. Struktura e prokurorisë së përgjithshme”. Dakord?

Neni 62. Dakord.

Neni 63, “Sekretari i Përgjithshëm”.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Me riformulimin që të bëhet me katër paragraf neni 63. Dakord.

Neni 64, “Prokurorët e komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme”.

Duhet të kalojë pas nenit 66.

**Ulsi Manja** – Pas nenit 66.

**Fatmir Xhafaj** – Duhet shtuar fjala “Gjykatë e Lartë”. Në të thuhet: “Për çdo objekt gjykimi në gjykatën dhe Gjykatën Kushtetuese”. Pra, duhet të thuhet: “Në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese”.

Kjo është logjika besoj, apo jo?

**Ulsi Manja** – Po, patjetër.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord me nenin 64 me sugjerimet që u bënë.

Neni 65, “Sektorët e ekspertizës”, me sugjerimet që u bënë në nenin 64, me ndryshimet.

**Artan Hoxha** – E vetmja gjë që është parimore, meqenëse e thamë se do ta diskutojmë kur të vijë, do t’ua lëmë këtyre përfaqësimin e prokurorisë për çështje gjyqësore të karakterit civil administrativ? Ne vetë kemi pasur debat dhe personalisht do të thosha jo, në qoftë se ka leje.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

“Sektorët e ekspertizës”.

**Ulsi Manja** – Lidhur me “Sektorët e ekspertizës” kam unë një pyetje.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Ulsi Manja** – Për çfarë sektorësh ekspertize flitet sot? Lidhur me ekspertizën që jepet në prokurori për çështje të caktuara penale funksion shërbimi i ekspertizës pranë laboratorit qendror kriminalistik dhe sigurisht ka edhe ekspertiza të natyrës tjetër që e ofrojnë ekspertë, që janë pranë institucioneve publike, por mund të jenë edhe ekspertë të pavarur. Në këtë nen bëhet fjalë për të vazhduar me të njëjtat shërbime të ekspertizës siç ofrohen edhe sot, apo pranë prokurorive do të ketë një sektor ekspertize që do të jenë në vartësi të prokurorisë?

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Jon Smibert** – *(flet anglisht)* Kjo është hartuar për SPAKU-n, por më pas vendosëm që ta kishim për SPAKU-n dhe disi donim ta kishim edhe këtu. Ndoshta është momenti për ta rimenduar edhe një herë këtë gjë, ndoshta nuk është e mirë për ta pasur në një prokurori të zakonshme, ndoshta do të duhej të ishte në prokuroritë për juridiksionet speciale, të veçanta, të specializuara dhe ndoshta kjo do të ishte më e mira vetëm për SPAKU-n. Gjithashtu, mendoj se kemi nevojën për çdo zyrë, në qoftë se do të kishim shumë raste, për të pasur dikë në zyrë me ekspertizën, për të kaluar me një çështje të caktuar, pra është e domosdoshme, është e dobishme. Me prokurorin e Përgjithshëm mund të jetë e nevojshme që të kemi ekspertë të natyrave të ndryshme, pra janë ekspertë që tashmë punojnë nëpër zyra për të bërë gjëra të caktuara dhe nuk është se po themi se po zëvendësoni diçka...

**Fatmir Xhafaj** – Përfshihen në kompetencën vendore të prokurorisë së posaçme, si do të bëjmë për ekspertizën. Madje, 90% e veprave penale nuk përfshihen në kompetencën e SPAKU-t, hetimi i tyre ka nevojë për ekspertë.

*(Diskutim pa mikrofon)*

Urdhëro?

Kështu që nuk besoj, së paku, Prokuroria e Përgjithshme duhet të ketë sektorë të ekspertizës.

**Artan Hoxha** – Shërbimet e ekspertizës janë të organizuara, janë nën Ministrinë e Drejtësisë, nën autoritetin e Këshillit të Ministrave...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, se nuk mund t'i marrim t'i fusim të gjithë tani meqenëse do të bëhet SPAKU dhe të gjitha të ngecen atje. Po të tjerët çfarë do të bëjnë? Po kriminaliteti urban, krimi urban që është...?

**Artan Hoxha** – Ky rregullim nuk është për SPAKU-n, sepse ai e ka rregullimin në ligjin e vet. SPAKU ka ekspertizën e vet për fushën ...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, nuk kemi pse e heqim këtë, por mund të themi “shërbimi ekspertizës” dhe ta përmbledhim dhe t'i kemi të gjitha?

**Artan Hoxha** – Kurse kjo që themi ne këtu nuk përjashton shërbimin e ekspertizës qendrore.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, jo patjetër!

**Artan Hoxha** - Ne themi që vetë prokuroria ka ekspertë dhe jo vetëm ekspertët që i vijnë nga qeveria apo nga Ministria e Drejtësisë, por për veprimtarinë e saj të përditshme ajo nuk ka pse të mos jetë me një fjalë. Nuk është se po krijon një strukturë që do të zëvendësojë ekspertët procedural.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 66.

**Ulsi Manja** – Lidhur me asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm, neni 66, pika 2, numri 2 koordinator për disa prokurori rrethesh, ndoshta mund të jetë numër i madh, pasi ka prokurori rrethesh që përbëhen nga 2 prokurori me 8 prokurorë. Pra, mund të ketë 4 prokurorë një prokurori, katër tjetra dhe i bie të jenë 2 koordinatorë për këto subjektet me status të posaçëm. Mënyra e formulimit lë të kuptohet se edhe në prokuroritë me 3 apo 4 prokurorë mund të punësohen më shumë sesa 2 koordinatorë të diplomuar në psikologji, sociologji apo në fusha të tjera të posaçme, lidhur me asistencën që mund t'u jepet këtyre subjekteve. Ndoshta ka nevojë që ta riformulojmë këtë dispozitë.

Të paktën 2 koordinatorë, lë të kuptosh se mund të jenë më shumë sesa 2, ndërkohë që vetë prokuroria mund të ketë 3 prokurorë. Prandaj, duhet lënë sipas...

**Korajlka Bumçi** – *(flet anglisht)* Ajo që po sugjeroni ju është riformulim, sepse është diçka që duhet ta kemi, por ta riformulojmë.

**Fatmir Xhafaj** – Të mos kërkojmë gjëra që i kemi tej mundësive, ky është koncepti...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ekzakt. Pa numër fare, ka të drejtë. Kur është e nevojshme, mund të thuhet se mund të ketë edhe këtë, këtë... kur çmohet e nevojshme. Pastaj e çmon struktura që ndërtohet, ku në strukturë mund të jetë edhe kjo.

Në rregull neni 66 me ndryshimet.

**Ulsi Manja** – Propozohet më pas shtimi i nenit 66/a.

**Artan Hoxha** – Mund ta heqim atë dyshin fare...

**Fatmir Xhafaj** – Riformulojeni dhe më pas bëjeni në daç me heqje, në daç me.... Se heqje një fjalë goje është po e hoqe.

**Artan Hoxha** – Jo, vetëm dyshi.

**Fatmir Xhafaj** – Të heqim dyshin. Dakord.

A jeni dakord me nenin 66/a?

**Ulsi Manja** – Sugjeroj që të shtohet neni 66/a “Prokurorët e komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme”.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 66/b. A jeni dakord? Dakord.

Neni 66/c. A jeni dakord? Dakord.

Neni 67 “Trajnimi”. A jeni dakord?

**Ulsi Manja** – Të ndryshojë titulli dhe të bëhet “Formimi profesional”.

**Fatmir Xhafaj** – E ka bërë relatori këtë ndryshim, të cilin duhet ta respektojmë për punën që ka bërë.

Neni 67/a. A jeni dakord me ndryshimin?

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 67/b. A jeni dakord me ndryshimin? Dakord.

Neni 67/c. A jeni dakord me ndryshimin? Dakord.

Neni 67/ç. A jeni dakord me ndryshimin? Dakord.

Neni 67/d. A jeni dakord me ndryshimin?

**Ulsi Manja** – Lidhur me pranimin e nëpunësve civilë në prokurori, është e njëjtë gjë si te ligji tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – E kemi kaluar. Është i njëjti model. Thjesht në vend të fjalës “gjyqtar, është vendosur fjala prokuror.

Neni 67/dh. A jeni dakord me ndryshimin? Dakord.

Neni 67/e. A jeni dakord me ndryshimin? Dakord.

Neni 67/ë. A jeni dakord me ndryshimin? Dakord.

Neni 67/f. A jeni dakord me ndryshimin? Dakord.

Neni 67/g. Mund t’i rishikoni, siç kemi rënë dakord për të bërë redaktimet. A jeni dakord me ndryshimin? Dakord.

Neni 67/gj. A jeni dakord me ndryshimin? Dakord.

Seksioni 5 “Të drejtat; detyrimet; vlerësimi i punës; transferimi”.

Neni 67/h, A jeni dakord? Dakord.

Neni 67/i “Vlerësimi i veprimtarisë”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 67/j: pas seksionit 5 shtohet seksioni 6 “Pezullimi dhe përgjegjësia disiplinore”  
A jeni dakord me ndryshimin? Dakord.

Neni 67/k “Pezullimi nga shërbimi civil”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 67/l “Efektet e pezullimit”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 67/ll “Përgjegjësia disiplinore”. A jeni dakord? Dakord.



Neni 67/m “Afatet e parashkrimit”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 67/n “Afatet për fillimin e hetimit”. A jeni dakord ? Dakord.

Neni 67/nj “Fillimi i procedimit disiplinor”. Të gjitha këto janë norma të reja, të cilat janë përputhur me ligjin “Për statusin e magistratëve”.

Neni 67/o “Të drejtat e nëpunësit civil gjatë hetimit disiplinor”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 67/p “Procedurat disiplinore”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 67/q “Kriteret për caktimin e masave disiplinore”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 67/r “Pezullimi i hetimeve dhe procedimi disiplinor” . A jeni dakord? Dakord.

Këto do të jenë nene me vete, se do të ndryshojë komplet numërtimi i neneve.

Neni 67/s “E drejta për ankim”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 67/sh “Regjistrimet disiplinore”. A jeni dakord? Dakord.

Pas seksionit 6 shtohet seksioni 7 si më poshtë: “Ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil”.

Neni 67/t “Ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil të prokurorisë”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 67/th “Regjistrimi në regjistrin qendror të personelit”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 67/u “Rregulla dhe udhëzime për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil”. A jeni dakord? Dakord.

Të gjitha këto nene janë përqsasur me ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe do të keni mundësinë e redaktimit para votimit në tërësi. Ne i kemi kaluar ato dhe relatori së bashku me ekspertët kanë marrë të njëjtin formulim. Gjithsesi, edhe ekspertët ndërkombëtarë besoj se kanë mundësi të rakordojnë me zonjën Agnese, e cila është te grupi tjetër, për të parë përqsasjen, terminologjinë dhe janë të lirë të japin edhe një mendim për këto përpara se të votohen në tërësi. Në vlerësimin tonë, janë thjesht kopjime, duke ndryshuar gjyqësorin me prokurorinë, pra e kemi bërë për të ruajtur të njëjtin standard.

Neni 68 “Marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave”, i cili do të numërtohet ndryshe me futjen e atyre seksioneve që kaluam më sipër. A jeni dakord?

**Ulsi Manja** – Jemi dakord me nenin 68.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 69 “Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë”.

**Ulsi Manja** – Te “Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë” kemi bërë sugjerimet përkatëse, të cilat i janë bashkëngjitur tabelës.

**Fatmir Xhafaj** – Biem dakord me ndryshimet.

Neni 70 “Marrëdhëniet me Komisionin e Ligjeve”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 71 “Marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 72. A jeni dakord? Dakord.

Neni 73 “Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë”. A jeni dakord? Dakord.

**Petrit Vasili** – Kemi pasur shumë debat. Mendoj se, në qoftë se kemi ndonjë reflektim për të bërë, mund ta bëjmë këtu, se nuk kemi ku ta bëjmë tjetër. Po qëndroj te një detyrim konkret, ku thuhet: “Ministri i Drejtësisë ka detyrimin të depozitohet pranë Inspektoratit të Lartë ankesat që paraqiten kundër prokurorëve”. Çfarë bën ministri i Drejtësisë, vetëm merr ankesat dhe i transporton atje, apo bën verifikimet përkatëse dhe e çon dosjen e kompletuar tek inspektori? Nuk mund te jetë i njëjtë autoriteti i ministrit me të dikujt tjetër që shkon dhe depoziton një ankesë tek inspektori.

**Fatmir Xhafaj** – Jam dakord ta rishikojmë, por këtë gjë do ta bëjmë kur të shkojmë tek “Inspektori i Lartë i Drejtësisë”. Do t’ju lutem që edhe ju ta keni në vëmendje. Ka qenë një ide, këtu dua të mbështes qëndrimin parimor të zotit Rakipi, që ekzekutivi duhet të ketë një rol aktiv në marrëdhëniet me prokurorinë për shkak të rolit që ka qeveria në luftën kundër kriminalitetit. Kjo është një përgjegjësi kushtetuese, por është edhe përgjegjësi politike e ekzekutivit në raport me qytetarin, për sa kohë këtë përgjegjësi e merr qeveria kur e voton populli. Kjo është një ndër përgjegjësitë e rëndësishme që i jep populli një qeverie të caktuar dhe Kushtetuta ia ka njohur këtë përgjegjësi asaj. Është shumë e rëndësishme që të arrijmë ta koordinojmë veprimtarinë e organit ligjzbatues, natyrisht pa cenuar thelbin e autonomisë dhe të pavarësisë së vendimmarrjes së tij. Kështu që jam dakord për ta riparë rolin e ministrit të Drejtësisë.

Neni 73 mbetet i hapur.

Neni 74 “Marrëdhëniet me Policinë Gjyqësore”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 75 “Dispozita kalimtare”.

**Ulsi Manja** – Është plotësuar me riformulime.

**Fatmir Xhafaj** – Po, është bërë “Dispozita kalimtare për prokurorin ndihmësligjor në detyrë”, pastaj shtohet 75/a “Dispozita kalimtare për sekretarin e Përgjithshëm”.

Neni 76 “Dispozitë kalimtare për personat në detyrë”. A jeni dakord? Dakord.

Neni 76/a “Dispozitë kalimtare për nëpunësit e Prokurorisë së Posaçme, të cilën e ka shtuar. Kemi gjithmonë rezervën që edhe ekspertët ndërkombëtarë të njihen me dispozitat që keni shtuar ju. Nëse do të kenë diçka, mund t’u rikthehem.

Neni 76/b “Regjistri qendror i personelit”, për të cilin folëm gjatë gjithë kohës, do të shtohet këtu.

Neni 76/c. A jeni dakord? Dakord.

Alba, ju do t'i rishikoni kur të zbardhen, nëse do të keni diçka... I kaluam pak si shpjeg, sepse ishin thjesht përjasje me ligjin tjetër, por nuk e di si mund të rrinë te ligji që keni ju për Prokurorinë e Posaçme.

Neni 77. A jeni dakord? Dakord.

Neni 78 "Hyrja në fuqi". Edhe kjo është e hapur, por në parim jemi dakord.

Këtu e mbyllim të gjithë ligjin "Për Prokurorinë e Përgjithshme". Kemi lënë të paktën 4-5 nene të hapura, të cilat do t'i ridiskutojmë. Kemi rënë dakord për të shtuar disa nene që përputhen me ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", një sërë nenesh të rëndësishme, sidomos ato që kanë të bëjnë me administratën në prokurori, e cila deri më sot nuk ka qenë e rregulluar fare. Kjo është një gjë shumë pozitive, sepse vendosim të njëjtin standard për të dyja administratat respektive, atë të gjyqësorit dhe atë të prokurorisë. Janë edhe një sërë nenesh të tjera që sistemojnë më mirë ligjin. Ju mbetet detyra ekspertëve të nivelit të larë, sekretariatit teknik pranë tyre dhe këshilltarëve të komisionit në një diskutim me relatorin që deri pasnesër të bëjnë bërë një risistemim të të gjithë projektit, duke parë ku ndryshon dhe ku nuk ndryshon dhe pasnesër ne duhet ta kemi këtë dokument në dorë për të diskutuar se cilat do të jenë pikat e hapura. Mendoj që e mbyllim këtu këtë projektligj, ndërkohë i japim të drejtën relatorit ta prezantojë sot relacionin për ligjin e SPAK-ut dhe nesër të fillojmë shqyrtimin nen për nen të këtij ligji.

Zoti Manjana, a jeni gati? Edhe një herë, faleminderit për punën që keni bërë dhe për kontributin që keni dhënë për ligjin për prokurorinë! E mbyllim këtë pikë të rendit të ditës këtu dhe vazhdojmë me pikën tjetër: me paraqitjen e vlerësimit të relatorit për projektligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Materiali i relatorit është shpërndarë. Kështu që unë besoj se ai do të bëjë një përmbledhje të shkurtër të pikave kryesore të këtij projektligji për shkak se është një dokument (do të jetë edhe relacioni i komisionit për Kuvendin) që do të pasurohet edhe nga diskutimi nen për nen, por ky është një vlerësim në parim. Kjo do të thotë se ai duhet të paraqesë dy-tri momente kryesore për projektligjin, për t'i hapur nesër rrugë diskutimin nen për nen të tij.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, relativimin lidhur me projektligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" e kam përgatitur me shkrim. Në mënyrë të përmbledhur relatimi është rreth 18 faqe. Për përshkrimin në mënyrë të detajuar të secilit nen të projektligjit...

**Fatmir Xhafaj** – 18 faqe janë vlerësim për projektligjin.

**Ulsi Manja** – Në fakt, vlerësim për projektligjin janë.

Në mënyrë të përmbledhur do të ndaloj lidhur me bazën kushtetuese të këtij projektligji, me qëllimin, me përmbajtjen tij, me nevojën pse lindi hartimi i një projektligji të tillë, përparësitë dhe risitë kryesore që sjell ai dhe nuk do të ndalem në detajimin e krerëve, seksioneve dhe neneve të caktuara të këtij projektligji, pasi këto do të jenë çështje të diskutimit nen për nen.

Projektligji është përgatitur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, që funksionon pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi. Është përgatitur me ekspertizën ndërkombëtare të nevojshme të misioneve ERAULIUS dhe OPDAT, të cilët kanë asistuar në mënyrë permanente me ekspertët e nivelit të lartë në këtë reformë. Natyrisht, projektligji është hartuar për të vënë në zbatim ndryshimet Kushtetuese, pra Strukturat e Posaçme Antikorrupsion dhe të Krimit të Organizuar, ku në terminologjinë e ligjit bën pjesë Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore, të cilat janë parashikuar rishtazi në ndryshimet kushtetuese, të cilat tashmë i janë paraqitur Kuvendit. Ky projektligj reflekton nenin 148 e në vazhdim të këtyre ndryshimeve kushtetuese. Pra, baza Kushtetuese e këtij projektligji janë ndryshimet kushtetuese të bëra në nenet 148 dhe 149 të draftit që pritet të votohet në Kuvend.

Projektligji synon të rregullojë organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme Antikorrupsion dhe Njesisë së Posaçme Hetimore; parashikon kushtet shtesë që duhet të përmbushin prokurorët për t'u emëruar në Prokurorinë e Posaçme, kushtet që duhet të përmbushin shtetasit për të qenë oficerë dhe punonjës në Njësinë e Posaçme Hetimore, kushtet që duhet të përmbushin për të qenë punonjës në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe në Prokurorinë Posaçme; parashikohen kompetencat e Prokurorisë së Posaçme dhe gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe parashikohen marrëdhëniet e Prokurorisë së Posaçme me institucionet e tjera shtetërore dhe me subjektet e tjera publike apo private dhe me publikun.

Projektligji synon të rregullojë organizimin dhe funksionimin e këtyre organeve, me qëllim përmbushjen e procesit të hetimit të sigurisë të së kaluarës së këtyre personave, të vëzhgimit të të dhënave financiare dhe të telekomunikacionit të gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, të oficerëve dhe të shërbimeve të Njesisë së Posaçme Hetimore.

Projektligji është hartuar bazuar në objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë, të tilla si: ndëshkueshmëria e veprave penale në fushën e korrupsionit, duke synuar forcimin e zbulimit dhe rritjen e kapaciteteve të hetimeve proaktive në këtë fushë; krijimi i strukturave të

specializuara antikorrupsion dhe ndalimin e fenomenit të korrupsionit me anë të plotësimit të kuadrit ligjor dhe të konsolidimit të politikës penale në këtë fushë.

Projektligji përbëhet nga 61 nene dhe është strukturuar në 9 krerë. Pse lindi nevoja e këtij projektligji?! Nga analiza e sistemit të drejtësisë në tërësi dhe asaj penale në veçanti janë konstatuar problematika në organizimin dhe në funksionimin e institucioneve, të cilat kanë pasur si objekt të veprimtarisë së punës së tyre luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Projektligji synon të adresojë disa probleme të rëndësishme, që janë identifikuar në dokumentin analitik për analizën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe janë evidentuar disa problematika dhe çështje, që lidhen me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat kërkojnë kapacitete të posaçme dhe të specializuara për t'i luftuar dhe adresuar si problematika. Cilat kanë qenë këto problematika që janë hasur në hetimin e këtyre veprave? Pasuritë e pajustificuara të disa gjyqtarëve dhe prokurorëve, emërime dhe promovime në funksione të rëndësishme të sistemit të drejtësisë, dhe këtu bëhet fjalë gjithmonë për gjyqtarë dhe prokurorë bazuar mbi kritere jomeritokratike dhe pothuajse tërësisht subjektive dhe të ndikuara. Vështirësitë e hasura nga përdoruesit e shërbimeve të prokurorisë dhe gjykatës, hetimet dhe ndëshkimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve për korrupsion në gjithë këto vite nga vetë sistemi i drejtësisë kanë qenë shumë zhgënjyese. Strukturës aktuale për hetimin e korrupsionit në nivel policie i mungon stafi i specializuar, madje shpeshherë hetimet e kësaj natyre kanë qenë tepër sipërfaqësore. Çështjet e drejtimit të vetë sistemit të prokurorisë dhe mënyra e emërimit dhe e ngritjes në detyrë krijojnë rrezikun që prokurorët të mos jenë të gatshëm të ndjekin penalisht çështjet e korrupsionit, ku përfshihen politikanë apo persona me ndikim të fuqishëm politik. Çështjet e kompetencës së hetimit të zyrtarëve të lartë nuk hetohen nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, që aktualisht kemi në sistem, sepse juridiksioni për veprat penale, që përfshin zyrtarët e lartë, sipas nenit 141 të Kushtetutës, më sistemin aktual i takojnë Gjykatës së Lartë. Pra, sot juridiksioni fillestar mbi zyrtarët e lartë, të cilët akuzohen për veprat penale të korrupsionit, është pranë kësaj gjykate. Për çështjet e koordinimit dhe mbikëqyrjes, ku prokuroria ka mangësi në praktikë, për sa i përket raportimit të çështjeve dhe monitorimit në mënyrë aktive të vendimeve të prokurorisë nga departamenti për hetimin e krimit ekonomik, korrupsionit dhe krimit të organizuar në kuptimin e parashikuar, projektligji parashikon ngritjen dhe funksionimin e njësisë së posaçme hetimore. Ndarja e veprave penale të korrupsionit ndërmjet Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe prokurorive të rrethit, ka krijuar mangësi në koordinimin ndërmjet tyre, aq sa sot, për shkak të mosqartësisë së kompetencave lëndore në hetimin e këtyre çështjeve, fillimi i çështjeve

penale të kësaj natyre, kryerja e tre-katër veprimeve hetimore, deklarimi i moskompetencës dhe përcjellja e çështjes nga juridiksioni fillestar i një prokurorie rrethi, duke lehtësuar pozitën procedurale dhe hetimore të personave që kanë qenë nën hetim lidhur me veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar është kthyer në një lojë ping-pongu. Më sipër thashë që nevoja për hartimin e këtij projektligji ka lindur edhe për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe kapaciteteve të duhura për hetimin e korrupsionit në të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit, të cilat, për shkak të detyrave që kanë, janë përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Problematikat janë hasur edhe me përdorimin e teknikave të posaçme hetimore, kur dihet që veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar janë vepra penale që, përpos rrezikshmërisë shoqërore që mbartin, kanë nevojë edhe për aplikimin e metodave dhe mjeteve të posaçme të hetimit, pasi dihet shumë mirë që janë vepra penale, të cilat nuk kanë vendngjarje. Problematika janë hasur edhe në gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, prandaj ka lindur nevoja që projektligji të parashikojë edhe krijimin e një gjykate të posaçme për gjykimin e veprave të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Çfarë synohet të arrihet me këtë reformë dhe me këtë projektligj? Synohet të arrihet rritja e ndëshkueshmërisë së veprave penale në fushën e korrupsionit duke synuar forcimin e kapaciteteve të zbulimit të këtyre veprave dhe të hetimeve proaktive nëpërmjet krijimit të strukturave të specializuara antikorrupsion. Gjithashtu, synohet minimizimi deri në ndalimin e veprave penale të korrupsionit edhe nëpërmjet plotësimit dhe pasurimit të kuadrit ligjor dhe konsolidimit të politikës penale në këtë fushë.

Cilat janë përparësitë e këtij projektligji? Projektligji për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar është hartuar në bazë të zbatimit të nenit 148, germa “dh” të amendimeve kushtetuese, dhe ka për synim të përcaktojë rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme dhe njësisë së pavarur hetimore; kushtet shtesë, tej atyre të parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, që duhet të përmbushin prokurorët për t’u emëruar në Prokurorinë e Posaçme; kushtet që duhet të përmbushin shtetasit për të qenë gjyqtarë në Gjykatën Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; strukturën e Prokurorisë së Posaçme dhe krijimin e një policie të specializuar përgjegjëse për rastet e rënda të korrupsionit, që, referuar ligjit, do të quhet Byroja Kombëtare e Hetimit, si dhe rregullat dhe procedurat që duhet të zbatohen në rastin e rekrutimit të burimeve njerëzore, që do të punojnë pranë këtyre strukturave.

Ligji ka përcaktuar qartë kompetencat e këtyre strukturave në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjithashtu, projektligji ka përcaktuar edhe marrëdhëniet e kësaj prokurorie me institucionet e tjera përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Projektligji synon dhe garanton statusin e veçantë të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të SPAK-ut dhe të hetueseve të Byrosë së Hetimit, garanci që lidhen me palëvizshmërinë e tyre nga detyra, paanshmërinë dhe mundësitë që kanë në përzgjedhjen e këtyre individëve me integritet të lartë moral dhe profesional, që do të punojnë në këto struktura. Gjithashtu, garanton një strukturë të pavarur, e cila funksionon sipas parimeve të qëndrueshmërisë, besueshmërisë dhe qartësisë së kompetencave, kurse trajtimi dhe përfitimet e duhura financiare janë një mekanizëm shtesë garancie për punonjësit që do të punojnë në strukturat e SPAK-ut dhe në Gjykatën e Posaçme Antikorrupsion, e cila garanton integritetin e tyre profesional dhe moral.

Natyrisht, misioni i kësaj prokurorie është përfaqësimi i akuzës në emër të shtetit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar para gjykatës së shkallës së parë. E veçanta është që do të kemi vetëm një Prokurori të Posaçme antikorrupsion, e cila do të funksionojë dhe do të jetë përgjegjëse për përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit në të tria shkallët e gjyqimit. Në mënyrë telegrafike po jap vetëm risitë kryesore të këtij projektligji.

Risia e parë është pavarësia funksionale e Prokurorisë së Posaçme nga Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet e tjera publike, dhe mënyra se si sigurohet kjo pavarësi funksionale është e detajuar në një relacion, të cilin do t'juaj vëmë menjëherë në dispozicion.

Së dyti, është pavarësia e brendshme e prokurorëve të posaçëm nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorët e tjerë në ushtrimin e funksioneve të tyre. Këtë pavarësi të brendshme të prokurorëve, projektligji e garanton edhe në parashikimin që është bërë, pasi nuk lejon kontrollin apo influencimin nga jashtë të kësaj strukture të posaçme hetimi edhe në rastin kur ka implikime të prokurorëve dhe hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit në vepra penale. Pra, projektligji ka tentuar të japë shkallën maksimale të pavarësisë së kësaj strukture nëpërmjet parashikimit të hetimit të prokurorëve dhe hetuesve të zyrës nga prokurorët e tjerë të zyrës, dhe jo një hetim nga jashtë të prokurorëve dhe hetuesve të kësaj strukture kur ata implikohen në vepra penale.

Së treti, projektligji parashikon pavarësinë e njësisë së posaçme hetimore nga administrata e policisë, por ajo që ia vlen të theksohet është që kjo pavarësi lidhet me faktin se njësia e posaçme hetimore do të ofrojë shërbime hetimi për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar vetëm për Prokurorinë e Posaçme. Natyrisht, në ndihmë të njësisë së

posaçme hetimore do të jenë edhe shërbimet e atashuara të Policisë Gjyqësore dhe këtu e kam fjalën për shërbimet e Policisë Gjyqësore që sot ofron Policia e Shtetit, e cila ka në dispozicion burime njerëzore, mundësi teknike dhe kapacitete më të mëdha për t'ia ofruar këtë ndihmë Prokurorisë së Posaçme dhe njësisë së posaçme hetimore në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Çështja e pestë ka të bëjë me skanimin rigoroz të pasurisë dhe figurës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve, që do të punojnë në strukturat e posaçme të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si kusht paraprak dhe i detyrueshëm për rekrutimin e tyre në këto struktura, si dhe statusin e tyre.

Çështja e gjashtë është ngritja e një seksioni për asistencën e individëve me status të posaçëm, dhe një parashikim të tillë e kishim edhe te ligji që sapo kaluam. Këtu bëhet fjalë për individët me status të posaçëm në kuptim të Kodit të Procedurës Penale, përfshirë edhe viktimat e këtyre krimeve, si edhe dëshmitarët në hetimet që do të kryejë kjo prokurori, kjo pasi dihet roli i këtyre individëve me status të posaçëm, në zbulimin dhe dokumentimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Projektligji, në shërbim të ecurisë së hetimeve apo hetimeve të përbashkëta, ka parashikuar figurën e ndërlydhësit me organet e huaja, dhe kjo është një risi e këtij projektligji. Risi tjetër është ngritja e seksioneve të ekspertizës dhe hetimit financiar pranë Prokurorisë së Posaçme me mjete dhe ekspertë të kualifikuar për hetimin e veprave penale. Për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e këtyre strukturave në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, projektligji parashikon edhe detyrimin e këtyre organeve shtetërore që të bashkëpunojnë brenda kuadrit ligjor me strukturat e posaçme antikorrupsion.

Në një kre të posaçëm, projektligji ka parashikuar në mënyrë të hollësishme organizimin dhe funksionimin e njësisë së posaçme hetimore që më vonë do të quhet BKH. Po ashtu, në një kre tjetër janë parashikuar rregullat për punonjësit e njësisë së posaçme hetimore dhe këtu bëhet fjalë për kushtet dhe kriteret shtesë që duhet të plotësojnë këta persona në mënyrë që të arrihet jo vetëm standardi i kualifikimit profesional, por edhe standardi i etikës morale që duhet të kenë këta persona që do të hetojnë veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Unë nuk do të zgjatem më shumë lidhur me trajtimin e të gjitha çështjeve, sepse projektligji është shumë i detajuar dhe ka marrë në konsideratë gjithçka që ka lidhje me garantimin e pavarësisë së këtyre strukturave, si edhe me krijimin e kushteve dhe trajtimin të duhur qoftë për sa u përket kushteve të punës, por edhe trajtimin financiar. Pra, gjithçka është parë në këndvështrimin e pasjes së një strukture të pavarur, solide dhe të pandikueshme në



ushtrimin e veprimtarisë së saj hetimore. Natyrisht që nuk përfundon gjithçka sot me hartimin e këtij projektligji, sepse në diskutimet tona nen për nen, ne jemi të hapur dhe mirëpresim çdo vërejtje dhe sugjerim në drejtim të përmirësimit të ligjit, por pa prekur thelbin dhe përmbajtjen e këtij projektligji, sepse tashmë ajo është e përcaktuar në amendamentet kushtetuese që janë dorëzuar në Kuvend. I ftoj kolegët dhe ekspertët e pranishëm, por edhe të tjerë që kanë qenë prezent në komision në diskutimin e paketës ligjore, që në diskutimet tona nen për nen, këtë projektligj ta shikojmë të harmonizuar edhe me ligjet e tjera që afektojnë njëri-tjetrin, siç është ligji për prokurorinë, ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ligji për organet e qeverisjes gjyqësore, si edhe ligji për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, në mënyrë që edhe nga pikëpamja e hartimit dhe teknikës legjislative të kemi terma ligjorë dhe proceduralë të unifikuar për ta bërë sa më të thjeshtë këtë ligj nesër në zbatimin e tij në praktikë. Përtej kësaj tryeze që po diskutojmë ne sot, me këtë ligj do të punojnë prokurorët, oficerët e Policisë Gjyqësore, gjyqtarët, por edhe shërbimet e tjera të Policisë Gjyqësore, që do të kenë akses në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit, zoti Manja, për relatimin dhe për shtjellimin që i bëtë qëndrimit tuaj lidhur me përmbajtjen e projektligjit, me qëllimin që ky projektligj ka, me risitë që sjell, me pritshmëritë që ka qytetari shqiptar ndaj këtij akti legjislativ të rëndësishëm!

Natyrisht, nuk është e tepërt të them se ky është një ndër ligjet më të rëndësishme të paketës për reformimin e sistemit të drejtësisë. Përsëri nuk gaboj kur them se është një ndër ligjet e paketës, që nuk synon thjesht reformimin e sistemit të drejtësisë, por synon të ndikojë dhe të përmirësojë mënyrën se si ne sillemi me pushtetin, me qeverisjen, me buxhetin, me pasuritë e këtij vendi e të tjerë.

Në këtë kontekst, është një ligj që afekton, para së gjithash, vetë sistemin, sepse ndikon në ndershmërinë e sistemit, në eficiencën e sistemit, në pastërtinë e sistemit së brendshmi, por afekton ndjeshëm në rolin që ka sistemi në luftën kundër krimit të organizuar dhe, në mënyrë të veçantë, në luftën kundër korrupsionit. Kjo është një gjë themelore, një element kyç i qëllimit dhe i pritshmërisë së këtij projektligji.

Natyrisht, jam dakord se ligji zë vend të parë edhe për të reflektuar gjëra që e ndihmojnë atë për të qenë më i kapshëm, më i kuptueshëm, më i zbatueshëm nga organet ligjzbatuese, të jetë sa më i qartë për ata që do të merren me zbatimin e tij, por edhe të jetë sa më eficient në institucionet që do të ngrihen në bazë dh në zbatim të këtij ligji. Natyrisht, për sa kohë që bota njerëzore është mbështetur dhe funksionon mbi bazën e ligjit, nuk di të ketë

pasur ligj perfekt dhe nuk besoj se do të ketë, por ne duhet të synojmë që të jetë një ligj sa më i mirë edhe për një arsye tjetër. Ky është një ligj që ka shumë kritika dhe duke qenë se ka shumë kritika, ka edhe shumë kundërshtarë për arsyet që dihen, sepse prish interesa, prish rehati, ndryshon sjellje, qasje dhe ne duhet të jemi shumë më të kujdesshëm, në mënyrë që askujt të mos i japim mundësinë, sado të vogël, që qëllimin e mirë, risitë dhe pritshmëritë që kanë qytetarët dhe ne të gjithë ndaj këtij projektligji, të mund të përdoren negativisht në një kohë të dytë jo thjesht dhe vetëm nga ata që do ta zbatojnë, por, në mënyrë të veçantë, edhe nga ata që do ta kundërshtojnë sot dhe nesër në procesin e zbatimit. Natyrisht, në procesin e zbatimit, sidomos për ligje të kësaj natyre, ka luftëtarë të ligjit, por ka edhe nga ata që kërkojnë ose t'i bëjnë bisht ligjit, ose të përfitojnë nga hapësirat që lejon ligji, ose ta deformojnë zbatimin e ligjit. Pra, detyra jonë është që të shikojmë se cilat janë pikat që mund ta bëjnë shumë më eficient, më të zbatueshëm këtë projekt në vijimësi.

Gjithsesi, në parim kolegët janë shprehur gjatë diskutimit të projektkushtetutës, si dhe në diskutimet e mëparshme lidhur me rëndësinë e këtij projektligji. Nesër në orën 10:00 në këtë sallë, do të vazhdojmë me procedimin e mëtejshëm të këtij projektligji.

Edhe një herë faleminderit për vëmendjen, për angazhimin dhe për kontributin tuaj!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*